

BORDO

MARS
2026

MODELE: XHESIKA GJINAJ

MUZAT E MARSIT

VALENTINA LESKAJ
AURORA DAJA
ÇILJETA XHILAGA
RENISA LACKA
SOFJOLA KOTELLI
FLORA NIKOLLA
LINDA SHALA

Men

SARDI
STRUGAJ

EVENTE

ENXHI NASUFI
PUZZLE TIRANA

3
DESTINACIONE
girls
TRIP

LIBRI -20%
"SHIJET TONA"

DHURATA
PERFEKTE



GLOW UP SEASON

GUIDA E PRANVERËS/ NGA VESHJET TEK AKSESORËT,
TENDENCAT E BUKURISË DHE STILI I JETESËS!

At'Nikolla ATELIE

WWW.ENADAATNIKOLLA.COM
ENADAATNIKOLLA
RR: "THEMISTOKLI GËRMENJU" PALLATI AMBASADOR,
AP: 8 TIRANA - ALBANIA
+ 355 68 60 000 20 info@enadatnikolla.com

MODELE: XHESIKA GJINAJ
STILISTE: ENADA AT'NIKOLLA
FOTOGRAFIA: ENDRIT MËRTIRI
MUA: HENRI GJATA
HAIR: FLORII_HAIRSTYLE





OVS



LES COPAINS

 TOPTANI

Kati i 3-të.

OVS



PIOMBO

 TOPTANI

 +355 4 454 0926

 @ovstirana

Join us in a world full of class, and a glass full of wine.



21 WINES

 21wines

 Toptani Shopping Center, Kati -1

21 WINES

Përzgjedhjet tona për ju!

Nga rosé-t aromatike tek verërat e kuqe me karakter të thellë,
21 Wines sjell një përvojë unike shijeje, ku tradita dhe modernia takohen natyrshëm.



Fürst Castell

Nga rajoni Franken në Gjermani, me 14% alkool, sjell identitet të fortë dhe freski të balancuar në çdo gotë. Nota intensive pjeshke, dardhe vreshti, agrume të freskëta dhe lule të bardha karakterizojnë këtë Riesling nga kantina Castell, një verë me shije të qëndrueshme.



BAROLO "Serralunga" 2020

Nga rajoni Piemonte në Itali, me 13.5% alkool, sjell strukturë të rafinuar dhe precizion të admirueshëm në çdo gotë. Nota barishtore, mente dhe erëza delikate karakterizojnë këtë Nebbiolo 2020, një verë që evoluon bukur dhe kërkon kohë për t'u shijuar.



Gevrey-Chambertin 2015

Nga Gevrey-Chambertin në Burgundy, ky Pinot Noir nga vreshta të vjetra sjell thellësi dhe karakter të përqendruar. Nota qershie dhe erëzash delikate, me strukturë të balancuar dhe fund elegant.

ALVIERO MARTINI

1^A CLASSE



- ✦ TIRANË - RRUGA "ABDYL FRASHERI", PRANË LIBRIT UNIVERSITAR
- ✦ TIRANË - TOPTANI SHOPPING CENTER
- ✦ TIRANË - TEG CENTER
- ✦ TIRANË - RING CENTER
- ✦ TIRANË - COIN CENTER
- ✦ DURRËS - BULEVARDI "DYRRAH"
- ✦ VLORE - BULEVARDI "ISMAIL QEMALI"

bordo.al

BORDO

MARS 2026

BORDO STYLE

- 22. Bordo IN
- 26. Pranverë '26 – Mëndafsh & Minifunde
- 30. Pranverë '26 – Sport Class & Vija
- 32. Pranverë '26 – Dallgë Thekësh
- 34. Pranverë '26 – Lavander & Lëkurë
- 36. Pranverë '26 – Night mood & Super kostume
- 38. Pranverë '26 – Terapi blu & Lule 3D

- 40. Aksesorë '26 – Nostalgjia
- 42. Aksesorë '26 – 15 çanta ikonike
- 44. Beauty '26 – 4 trende bukurie
- 45. Beauty '26 – Ylber mbi thonj
- 46. Beauty '26 – Prerjet IN të flokëve
- 47. Beauty '26 – Aromat e pranverës



NË KOPERTINË
 MUZAT E MARSIT
 VALENTINA LESKAJ
 AURORA DAJA
 ÇILJETA XHILAGA
 RENISA LACKA
 SOFJOLA KOTELLI
 FLORA NIKOLLA
 LINDA SHALA

PRANVERË '26
TENDENCAT
 FASHION & BEAUTY

MEN
 SARDI STRUGAJ



GOLDFIELD & BANKS

AUSTRALIA



ROSE MAGNITUDE
 EAU DE PARFUM

BORDO MEN

- 76.** Gadget
- 77.** Estetikë Men
- 78.** Cover Men – Sardi Strugaj
- 82.** Trend Men – Pranverë 2026
- 84.** Men W – Marc Jacobs



PERSONAZHE

- 46.** Intervistë – Natalie Portman
- 50.** Speciale 8 Mars – Valentina Leskaj
- 54.** Speciale 8 Mars – Aurora Daja
- 58.** Speciale 8 Mars – Sofjola Kotelli
- 61.** Speciale 8 Mars – Flora Nikolla
- 64.** Speciale 8 Mars – Linda Shala
- 68.** Speciale 8 Mars – Renisa Lacka
- 72.** Speciale 8 Mars – Çiljeta Xhilaga



STIL JETESE

- 86.** Interior – Prekje artizanale
- 89.** Interior – Pjatat retro
- 88.** Receta nga Conad
- 91.** Art – Oltsen Gripshi
- 92.** Travel nga Perla's Travel
- 94.** Travel nga Eda Bano
- 97.** Event – Puzzle Tirana Experience
- 98.** Bibliotekë – Librat e marsit
- 99.** Kolonë nga Doreada Mio
- 100.** Horoskopit – mars 2026



96

EVENT – PROMOVIMI I
LIBRIT TË ENXHI NASUFIT



@esteljewelry
@esteljewelry_kosova

Toptani Shopping Center, Kati 0
+355 69 20 60 504
Prishtina Mall, Kosova
+383 488 876 88

1
La Bonne Brosse



NJË CLEAN GIRL
KUR FLOKËT E SAJ DUKEN RICH

2
AUGUSTINUS BADER
NJË CLEAN GIRL
KUJDESET PËR FLOKUN QË NË SKALP



CLEAN GIRL

ESSENTIALS

by
EURO PROFUMERIE



BUBBLE BATH
NJË CLEAN GIRL
MBAN GJITHMONË
AROMË "CLEAN"

3



SALT & STONE
NJË CLEAN GIRL
KA LËKURË SUPER TË LËMUAR

5



GROWN ALCHEMIST
NJË CLEAN GIRL
NUK PRANON INGREDIENT TË DËMSHËM
NË RUTINËN E SAJ TË FYTYRËS



WESTMAN ATELIER
NJË CLEAN GIRL
PËRDOR MAKEUP MINIMALIST

4



BODYOLOGIST
NJË CLEAN GIRL
KA GJITHMONË SHPUTA TË BUTA SI BEB



WESTMAN ATELIER
THE *NEW* HYDROBALM

EURO PROFUMERIE

BORDO

Nën kujdesin e
ENADA AT'NIKOLLA

Drejtores

Ilda Lumani

Kryeredaktor

Olsi Kolami

Gazetare

Brunilda Gorovelli
Klesara Beqiri

Në këtë numër bashkëpunuan

Endrit Mërtiri
Andis Rado
Renuar Locaj

Design & Layout

Altin Aliaj

Marketing

Florida Gavoçi

  **Revista BORDO**

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.
BORDO është markë e regjistruar.
Ndalohet me ligj çdo përdorim i materialeve
apo riprodhim i tyre pa lejen e botuesit.

ABONIMET

NJË VIT ABONIM NË BORDO
KUSHTON 5000 LEKË/ 50 EURO

+355 68 20 69 959  info@bordo.al



Rruga: "Ismail Qemali", përballë
"Ambasador 1", Tiranë

www.bordo.al



letra e editores

MARSI I GRAVE *dhe i ripërtëritjes*

Pas një dimri të gjatë, si rrallëherë në vend në fakt, ku shiu duket se ishte emëruesi i gjithë bisedave, dielli ka dalë këtë fund shkurti për të na lajmëruar pranverën në sfond. Dhe marsi në BORDO është lajmëtari i parë i asaj që duhet të shoqërojë këtë sezon; nga tendencat, të cilat vijnë si një buqetë me më të mirat që ofrojnë krijuesit e modës në botë, e po ashtu edhe atë çfarë kanë përçafuar sipërmarrësit shqiptarë për të sjellë te blerësit shqiptarë përmes boutique-ve të tyre apo edhe dyqaneve të markave. Kjo guidë stili është e duhura për të qenë sa më IN me kohën. Në të njëjtën frymë ecin edhe faqet e stilit dhe aksesorëve, të cilët janë sa avangardë e të guximshëm, po aq edhe praktikë, duke ofruar të duhurën për çdo njeri. Ky është numri i grave, kjo sepse më shumë se kurrë buqeta e personazheve që vijnë në atmosferën e 8 Marsit na ndërgjegjësojnë për të evidentuar më shumë se kurrë modelet që duhet jo vetëm të promovohen, por edhe të shihen si frymëzim për brezin e ri. Këtë herë na bashkohen: politikanja Valentina Leskaj, inxhinieria Aurora Daja, producentja nga Kosova Linda Shala, gazetaria dhe drejtuesja e "Albanian Excellence", Flora Nikolla, drejtuesja e Turizmit të Giz, Sofjola Kotelli, sopranoja Renisa Lacka, artistja Çiljeta Xhilaga dhe sipërmarrësj Romina Lula.

Ndërkaq, në "Bordo Men" një artist i ri dhe me shumë potencial si Sardi Strugaj ndan eksperiencat e tij dhe pritshmëritë për muzikën. I bashkohet këtë numër revistës BORDO gazetaria Doreada Mio, me një rubrikë të re "50 ngjyrat e Adës", ku do të sjellë tematika aktuale, të para në një këndvështrim origjinal, por edhe pak shpotitës për shoqërinë e konsumit. Në kuadër të muajit të grave, agjencia e udhëtimit "Perlas Travel" na sugjeron 3 destinacione për të bërë udhëtime vajzash. E po ashtu, udhëtarja jonë Eda Bano, na sjell Zakopanën, në Poloni, një vend gati i padëgjuar për shumicën, por me plot arsye për t'u vizituar. Ndërkohë, për të gjithë lexuesit e BORDO-së, që po mendojnë të bëjnë një dhuratë ndryshe për nënat, motrat apo mësueset libri "Shijet tona" gjatë gjithë muajit mars do të jetë me 20% ulje. Mënyrën se si zbuloheni në faqet e BORDO-së. Mars të mbarë dhe motivues për të gjithë!

nja Ilda Lumani

 **Instagram** ildalumani

info@bordo.al | Reklama dhe Promocion marketing@bordo.al

VITE KËRKIME, PËR T'U DHËNË FEMRAVE NJË LEHTËSIM TË MENJËHERSHËM



GINE TANTUM



Sepse kujdesi për zonën intime është hapi i parë i rëndësishëm për një shëndet të mirë.

 **MEDICAMENTA**


ANGELINI

Anti-inflamator, antiseptik anestetik sipërfaqësor.

Pyesni mjekun ose farmacistin tuaj për informacion shtesë.

STYLE

BORDO

PRANVERË/ VERE

2026



Ekskluzivisht distribuuar nga Albanian Distribution & Development
☎ +355 68 600 0081 | 🌐 www.add.al
📱 fentimansalbania



BORDO

IN



UNAZA FLEX NGA ESTEL JEWELRY

"Flex'it Ring" nga Fope është një ikonë e luksit italian që bashkon mjeshtërinë artizanale me inovacionin modern. E realizuar në rose gold me strukturë fleksibël unike, ajo përshatet në mënyrë perfekte në gisht, duke ofruar komoditet të jashtëzakonshëm dhe elegancë të përjetshme. Një unazë minimaliste, por me prezencë të fortë.



TRIBAL LEATHER BAG

Kjo çantë në kamosh, në nuancën blu pastel – ngjyra e momentit – është një "must-have" për sezonin. Elegante dhe moderne, ajo sjell freski dhe rafinim në çdo paraqitje. Perfekte me kostum bezhë për stil urban chic, apo me xhinse dhe këmishë të bardhë për një look bashkëkohor dhe plot personalitet.

ON A DATE REPLICA NGA EUROPARFUMERI

Një parfum sensual dhe elegant që kap magjinë e një takimi perfekt. Nota të freskëta rrushi dhe bergamoti hapin aromën, ndërsa trëndafili i Damaskut dhe patchouli krijojnë një gjurmë të ngrohtë, romantike dhe të paharrueshme. Ideal për mbërme speciale dhe momente intime.



KËMISHA STINE GOYA NGA COIN

Një pjesë që flet vetë. Silueta e butë, mëngët e fryra dhe valëzimet delikate krijojnë lëvizje dhe elegancë në çdo hap. Nuanca bezhë sjell qetësi dhe finesë, duke e bërë zgjedhjen ideale për kombinime të pastra dhe pamje të sofistikuara urbane.

ALVERO MARINI

1^A CLASSE

ALBANIA



BLUJA NË TREND, STIL NË ÇDO HAP

Atletja në nuancë blu pastel është protagoniste e këtij sezoni, duke sjellë freski dhe stil modern në çdo hap. Kombinoje me xhinse të çelëta, pantallona bezhë ose një fustan sportiv për një look urban dhe casual chic. Një detaj i sofistikuar që energjizon gardërobën pranverore.

TAKA GJEOMETRIKE JUST CAVALLI NGA MULTIBRAND

"Sandale me takë gjeometrike me detaje metalike" nga Just Cavalli janë një kombinim i sensualitetit me luksin modern. Me takën arkitekturore në finiturë gold dhe rripat me print leopard të theksuar me detaje gold, krijojnë një siluetë magnetike që tërheq vëmendjen në çdo hap. Sandalet e para Just Cavalli me detaje leopardi.



JUST B/ MINERAL WATER

Ekskluzivisht distribuuar nga Albanian Distribution & Development

+355 68 600 0081 | @ www.add.al

just_b_water

AN AIS

NJË AROMË QË NUK KALON PA U VËNË RE

"SCHERZO TRIO SET" SJELL NË NJË KUTI ELEGANTE TRE DIMENSIONE TË SË NJËJTËS MAGJI: INTENSITETIN E EXTRACT DE PARFUM, ELEGANCËN E EAU DE PARFUM DHE LEHTËSINË E HAIR & BODY MIST.



LANCÔME HYPNÔSE PALETTE



MILLER HARRIS
SCENTED CANDEL



CHANEL
ROUGE
ALLURE
VELVET

8 SUGJERIME PËR 8 MARS NGA

AN AIS



GUERLAIN
PARURE
GOLD MIST



MILLER HARRIS
SCHERZO HAIR MIST



BORN TO STAND OUT
SUGAR ADDICT



CHANEL LA
CRÈME MAIN



KERASTASE
CHRONOLOGISTE
FRAGRANCE IN OIL

AN AIS 1, RRUGA E ELBASANIT
+355 69 34 20 669

AN AIS 2, RRUGA "SAMI FRASHËRI", BLOK
+355 69 34 20 447



Mëndafsh

Vishni gjithçka prej mëndafshi nga koka te këmbët, një teksturë delikate e cila transmeton një ndjesi fleksibiliteti, që përqafon butësisht linjat femërore.



Sytë te këmbët

Gara sivjet është cili minifund është më i shkurti! Ky rikthim i veshjes ikonike risjell në vëmendjen elegancën e këmbëve kombinuar me ngjyra e forma mini përtej çdo aspekti estetik.

Bukuria e një gruaje

fillon me mënyrën si ajo ndihet.



Ajo është forcë dhe butësi, në të njëjtën frymë. Ajo është prania që mban gjithçka bashkë. Dhe shpesh, është e fundit që kujtohet për veten.

Marsi vjen si një kujtesë e qetë. Për gruan. Për nënën. Për çdo version të saj, atë që jep, që duron, që dashuron.

Sepse bukuria e vërtetë nuk është vetëm ajo që shfaqet. Është ajo që zgjohet kur ndalesh. Kur merr frymë më thellë. Kur kujdesi kthehet edhe tek ti.

Një prekje. Një moment qetësie. Një rikthim tek vetja.

Janë këto detajet e padukshme që rikthejnë dritën. Qetësinë. Dhe atë ndjesinë e rrallë të të qenit plotësisht mirë.

Sepse çdo grua meriton, ndonjëherë, të mos jetë ajo që kujdeset për të gjithë, por ajo për të cilën kujdesen.

Velur Spa





SARVARI

PARIS

The Future of Niche Perfumes

Ka aroma që thjesht ndihen dhe ka aroma që mbeten. Që lidhen me kujtime, njerëz dhe etapa të jetës, duke u shndërruar në pjesë të identitetit personal. Pikërisht në këtë hapësirë mes ndjesisë dhe kuptimit lindi "Sarvari Paris", një markë ku çdo aromë flet dhe çdo kujtim mbetet i gjallë. E frymëzuar nga pesë elementet themelore të jetës dhe nga përvojat personale e themeluesit Omar Sarvari, marka ndërthur përbërës natyralë të pastër, cilësi premium dhe elegancë për të krijuar aroma që nuk tregohen, por përjetojnë.

Vanille de Vie

E butë dhe elegante, Vanille de Vie sjell aromën e një vanilje kremoze dhe zemrën e ngrohtë të kashmiranit, ndërsa qelibari dhe myshku lënë një nuancë joshëse, moderne dhe klasike njëkohësisht. Një aromë që është njëkohësisht moderne dhe klasike, perfekte si për elegancën e përditshme ashtu edhe për momentet e veçanta. Vanille de Vie është projektuar për gruan ose burrin që guxon të shkëlqejë dhe dëshiron të rrethohet me një ambient të ngrohtë dhe joshës.

Pure Angel

Një aromë e freskët dhe energjike që zgjon shqisat. Notat e limonit dhe kumbullës sjellin një kombinim frutash, ndërsa livando, patchouli me nota lulësh sjell ekuilibrin midis freskisë dhe ngrohtësisë. Baza e vaniljes, qelibarit, drurit dhe një prekje molle lë një ndjesi mikpritëse dhe të qëndrueshme. Pure Angel është për ata që duan të shfaqin individualitetin e tyre dhe të nisin çdo ditë plot energji dhe siguri.

President

President hapet me një përzjerje të fuqishme freskie dhe elegancë të sofistikuar. Notat e mandarinës, bergamotës dhe livandos shkaktajnë menjëherë një ndjesi energjike, ndërsa zemra florale me iris, vjollcë dhe jase-min i shton aromës një prekje delikate dhe luksoze. Në bazë, fasula tonka, myshku dhe qelibari i japin aromës thellësi dhe karakter të qëndrueshëm. President është krijuar për udhëheqësin modern, që i përgjigjet çdo

sfidë me besim dhe stil. Një aromë që bën një deklaratë të fuqishme dhe ofron ekuilibrin perfekt mes freskisë dhe joshjes së përjetshme, ideale për çdo rast.

Nuit Rouge

Nuit Rouge ju çon në një udhëtim aventuresk përmes një peizazhi urban, plot energji dhe mister. Piper rozë dhe shafan ofrojnë një fillim të zjarrtë dhe emocionues, ndërsa zemra me mjedër të freskët, vetiver dhe livando sjell një dimension të gjallë dhe dinamik. Baza e fortë e myshkut, paçulit dhe drurit lë një gjurmë të fuqishme dhe të qëndrueshme. Nuit Rouge është për shpirtin guximtar, që dëshiron të bëjë një deklaratë të fortë dhe të ndjehet i gjallë në ritmin e jetës urbane.

Flamme de Neom

Flamme de Neom është një aromë magjepsëse që ju çon në një botë joshjeje të ëmbël dhe elegancë ekzotike. Notat e bajames dhe qershisë krijojnë një fillim të ngrohtë dhe ftues, i cili pasohet nga një zemër romantike e trëndafilut dhe pudrës. Baza e pasur me vanilje, dru sandali dhe dru agar krijon një ngrohtësi të rafinuar dhe afatgjatë që përkëdhel shqisat tuaja. Për ata që duan ta zbulojnë botën e "Sarvari Paris" pa nxitim, Discovery Set ofron pesë miniaroma nga 2 ml secila, një ftesë për të eksploruar, për të provuar dhe për të gjetur aromën që rezonon më fort me historinë personale. Në thelb, Sarvari Paris nuk përpiqet të jetë thjesht luks. Ai synon të jetë i vërtetë. Dhe pikërisht aty qëndron fuqia e tij.



SHITËS TË AUTORIZUAR PËR SHQIPËRINË:
BEAUTY POINT VLORE & JOENA COSMETIC



Vijat

Sivjet vijat nuk janë aspak klasike, sepse ato shkojnë përtej çdo parashikimi: janë me nuanca me shkëlqim dhe shpesh luhet me një shkallëzim të theksuar.



Sports class

Sportive, po duke ruajtur gjithmonë pak klas në pamjen tuaj! Ky kriter ruhet në sugjerimet e stilistëve, të cilët integrojnë elementet sport të ndërthura me prerje chic.



YVES ROCHER FRANCE

Brandi Nr. 1 për kujdesin e fytyrës në Francë që prej vitit 1959!

KUJDESI PËR LËKURËN FILLON QË NGA HEQJA E MAKIJAZHIT!

Lëkura e fytyrës ekspozohet çdo ditë ndaj shumë agresioneve të jashtme si: ndotja, grimi, filtrat diellorë, teprica e yndyrës duke shkaktuar pore të bllokuara, akne dhe dehidratim.

Yves Rocher ka një gamë të gjerë produktesh për heqjen e makijazhit dhe pastrimin e fytyrës duke ju përgjigjur nevojave të çdo tipi lëkure.

Hapi 1: Heqja e makijazhit duke përdorur produkte me teksturë vajore, qumësht pastrues ose ujë micelar.

Hapi 2: Pastrimi i fytyrës për të larguar papastërtitë me produkte me teksturë xhel, shkumë pastruese ose pastrues solid.

PASTRUESIT E FYTYRËS

3 linja profesionale, efektive dhe me aromë të këndshme

ME ALGA | ME ALGA & KAMOMIL | ME MENTE



DERI 99%

PËRBËRËS ME ORIGINË BIMORE

PURE ALGUE

Për të gjitha llojet e lëkurave



PURE ALGUE SENSITIVE

Për lëkura sensitive



PURE MENTHE

Për lëkura mikse, të yndyrshme dhe me imperfeksione



Adresat: Tiranë: 1.Qendra Tregtare Toptani, 2. Qendra Tregtare TEG, 3. Tek Libri Universitar, Rr "Abdyl Frashëri", 4. Rr. Muhamet Gjollësia
Shkodër: Tek pedonalja, përballë muzeut Marubi
Durrës: Bulevardi kryesor
Korçë: Bulevardi "Republika"





Dallgë thekësh

Thekë dhe tufa fijesh nuk janë vetëm për të shkëlqyer në pistën e vallëzimit: ky detaj do të shfaqet tejet sensual në veshje dhe aksesore me nuanca vibruese.



PRANVERA FILLON NGA CILËSIA E LËKURËS

Si ta rikthejmë lëkurën në gjendjen e saj natyrale pas dimrit - në klinikën

SMartderm

Çdo stinë lë një gjurmë të ndryshme mbi lëkurë, por dimri është ai që ndryshon mënyrën se si ajo funksionon. Temperaturat e ulëta, ajri i thatë dhe kalimi i vazhdueshëm nga ambientet e ftohta në të ngrohta e detyrojnë epidermën të trashet, ndërsa metabolizmi qelizor ngadalësohet. Lëkura duket më e zbehtë, më pak elastike dhe shpesh më reaktive ndaj pigmentimit apo irritimeve. Këto nuk janë vetëm ndryshime estetike sezonale; janë ndryshime biologjike që prekin mënyrën si rigjenerohet lëkura.

Për këtë arsye marsi konsiderohet nga dermatologët si periudha ideale për rikthimin e funksionit të lëkurës. Jo për transformime të menjëhershme dhe as për ndërhyrje agresive, por për rivendosjen graduale të aktivitetit fiziologjik të saj. Kur trajtimet kryhen në këtë moment të vitit, lëkura ka kohën e duhur të stabilizohet përpara ekspozimit intensiv ndaj diellit dhe të pësojë më pak dëmtime (hiperpigmentime) gjatë muajve në vijim.


Në këtë fazë synimi nuk është ndryshimi i tipareve, por aktivizimi i lëkurës. Procedurat si Dermaclear për eliminimin e qelizave të vdekura dhe rinovimin e sipërfaqes së lëkurës, mezoterapia për rikthimin e hidratimit biologjik, Faceboost për stimulimin e dermës dhe BabyGlow për uniformitetin e tonit dhe hidratimin e thellë, veprojnë në nivele të ndryshme të indit, duke e rikthyer gradualisht funksionin e tij natyral. Lëkura bëhet më e njëtrajtshme, më elastike dhe më rezistente, jo për shkak të volumit të shtuar, por sepse mekanizmat e saj normalë rifillojnë të aktivizohen.

Një nga aspektet më të rëndësishme të kësaj periudhe është edhe parandalimi i hiperpigmentimeve. Shpeshherë për njollat kërkohet trajtim në verë, pikërisht kur është shumë vonë për ta bërë në mënyrë të sigurt. Stabilizimi i melanociteve në pranverë rrit tolerancën ndaj rrezeve UV dhe redukton ndjeshëm rrezikun e melasmës sezonale, duke e bërë mbrojtjen me SPF realisht efektive.



Me afrimin e temperaturave të ngrohta, kujdesi estetik kalon natyrshëm edhe te trupi. Kjo është periudha më e përshtatshme për trajtimit që kërkojnë kohë biologjike për rezultat optimal. Epilimi progresiv me teknologjinë e avancuar të "Cynosure Elite IQ" redukton gradualisht densitetin e qimeve përpara verës, duke shmanjur irritime dhe folikulitet që zakonisht shfaqen gjatë muajve të nxehtë. Paralelisht, rimodelimi joinvaziv i trupit me platformën "Alma PrimeX" përmirëson mikroqarkullimin, tonusin, dhe cilësinë e lëkurës, redukton celulitin, dhe vepron mbi indin dhjamor në mënyrë të shpejtë e pa periudhë rikuperimi. Duke filluar në pranverë, organizmi reagon gradualisht dhe rezultatet shfaqen natyrshëm në prag të sezonit veror.

Estetika moderne nuk lidhet më me ndryshime të menjëhershme, por me mirëmbajtje të vazhdueshme dhe smart. Lëkura dhe trupi reagojnë më mirë kur trajtohen në mënyrë progresive gjatë vitit, duke respektuar ritmin biologjik të tyre dhe jo vetëm kalendarin e pushimeve. Kujdesi i duhur nuk është një moment i vetëm para verës, por një proces i vazhdueshëm që ruan cilësinë e indeve në çdo stinë — në mënyrë që rezultati të duket natyral gjatë gjithë kohës.



SMartderm
HEALTH/BEAUTY
KLINIKE DERMATOLOGJIKE & DERMOESTETIKE
DR.SILVANA MISHTAKU JANI

KONSULTA DERMATOLOGJIKE
MJEKËSI DERMO-ESTETIKE

+355 69 70 00930
RR. "PROKOP MIMA", TIRANË
Rezidenca Olimpik, Tirana, Albania 1000



Flirtoni me ngjyrën vjollcë: edhe pse aspak private për sytë, ju mund të zgjidhni gjithë gamën e tonaliteteve të saj, e cila dhuron një dimension magjepsës dhe efekt mistik.

Lavander



Lëkurë

Lamtumirë stilit rock! Ky sezon e sjell lëkurën në versionin e tij më romantik dhe më të butë, me prerje që theksojnë siluetën femërore dhe paleta ngjyrash plot shkëlqim.



Frymëmarrja me gojë DHE TRAJTIMI ORTODONTIK NË MOSHË TË HERSHME

këto probleme ndikojnë në përtpypje, të folur dhe cilësinë e gjumit. Tharja e vazhdueshme e gojës rrit gjithashtu rrezikun për karies dhe probleme me mishrat e dhëmbëve. Ndërhyrja në këtë fazë është vendimtare, sepse strukturat skeletike janë ende në zhvillim dhe reagojnë shumë mirë ndaj trajtimit ortopedik.

Frymëmarrja përmes hundës është thelbësore për zhvillimin normal të nofullave dhe strukturave të fytyrës. Kur ajo zëvendësohet nga frymëmarrja me gojë, për shkak të alergjive, infeksioneve të shpeshta, bajameve të zmadhuara, devijimit të septumit apo bllokimeve të tjera nazale, mund të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen skeletike dhe në pozicionimin e dhëmbëve. Te pacientët në rritje, frymëmarrja kronike me gojë shpesh shoqërohet me ngushtim të nofullës së sipërme, kafshim të kryqëzuar, mungesë hapësire për dhëmbët dhe profil të zgjatur të fytyrës. Përveç aspektit estetik,

Sipas Dr. Yllka Abazi, specialiste në ortodonci dhe e certifikuar edhe për diagnostikimin dhe trajtimin e problemeve të frymëmarrjes gjatë gjumit, ndërhyrja e hershme është thelbësore. Ajo thekson se trajtimi nuk duhet të fokusohet vetëm te drejtimi i dhëmbëve, por edhe te identifikimi i shkakut funksional të problemit, përfshirë çrregullimet e frymëmarrjes gjatë gjumit. Trajtimi te fëmijët fokusohet në terapi ortopedike që synojnë zgjerimin e nofullës së sipërme dhe përmirësimin e rrugëve të frymëmarrjes. Zgjerimi i hershëm i maksilës jo vetëm krijon hapësirë për dhëmbët, por ndihmon edhe në përmirësimin e funksionit respirator.

Tek adoleshentët, kur rritja skeletike është drejt përfundimit, përdoren metoda më të avancuara dhe të digitalizuara, si aparati MARPE (Mini-Implant Assisted Rapid Palatal Expansion). Kjo teknikë moderne ortopedike lejon zgjerimin skeletik të nofullës së sipërme me ndihmën e mini-implanteve, duke ofruar rezultate të qëndrueshme dhe të kontrolluara në mënyrë precize përmes planifikimit digjital.

Kjo qasje e integruar – që kombinon ortodoncinë, ortopedinë dentofaciale dhe vlerësimin e frymëmarrjes – nuk synon vetëm estetikën e buzëqeshjes, por edhe përmirësimin e funksionit respirator dhe cilësisë së gjumit. Diagnostikimi i hershëm dhe trajtimi i personalizuar në fazat e duhura të rritjes janë çelësi për rezultate afatgjata, funksionale dhe të qëndrueshme.





Night mood

Veshja e dhomës së gjumit del në dritën e diellit. Këmishat dhe sutjenat, pizhamet apo pantoflat, kanë një elegancë luksoze të përshtatshme për trotualet e qytetit.



Sivjet, kostumi është shumë i madh. Stilistët përqafuan supet e ekzagjeruara, krahët e gjera dhe pantallonat e gjera, duke vërtetuar se struktura nuk do të thotë domosdoshmërisht ngurtësi.

Super kostume



L&M
COMERCIAL

DOLOMITI

**BIRRA E FAMSHME ITALIANE
EKSKLUZIVISHT NË SHQIPËRI
NGA L&M COMERCIAL**

DOLOMITI ËSHTË NJË NGA BIRRA TË MË TË FAMSHME NË ITALI, PËR SHKAK TË ZONËS KU PRODHOHET DHE UJIT QË ËSHTË NË ATË ZONË, ÇKA NDIKON NË CILËSINË E BIRRËS!



Terapi blu

Nëse moda pasqyron humorin e momentit, atëherë bluja është terapia e duhur. Një nuancë optimiste e cila shfaqet nga fustanet elegante të viteve '40 te format sportive.



Lule 3D

Nuk janë lule, por skulptura maksimaliste. Përqafoni motivet floreale, te fustanet do të shfaqen zambakë në forma 3D deri te lulet e vogla të stilit vintage.




Z L A Z A

ZLAZA është një shtëpi artizanale parfumeshe e themeluar në vitin 2017, e ndërtuar mbi idenë se parfumi është art dhe emocion.

Çdo aromë është një histori – dashuri, kujtim, rilindje – e krijuar me mjeshtëri, lëndë premium dhe estetike minimaliste luksoze.

Brand-i pozicionohet në segmentin premium & niche, me shpërndarje selektive dhe target klientë të rafinuar, që kërkojnë identitetet përmes aromës. Universi i ZLAZA përfshin 8 koleksione të kuruara: White, Metaverse-AI, Hiraeth, Essence de Moi, Voglio D'amore, Gold, Classic dhe Oudh.



Z L A Z A



Rr. "Abdi Toptani"
Toptani Shopping Center, Kati 1
Pranë DeFacto



069 739 5411



ZLAZA nuk është vetëm parfum.

ZLAZA JE TI. ËNDRRAT E TUA. KUJTIMET E TUA. SHPIRTI YT I PASTËR. ARTI YT UNIK.

15 çanta IKONIKE

Mund të zgjidhni modelet mini ose maxi, më së shumti ato janë njëngjyrëshe, por mund të zgjidhni edhe ato me printime kafshësh. Modelet pranverore të çantave reflektojnë mbi gjithçka luksin, por edhe praktikitetin, me forma drejtkëndore, doreza prej lëkure kombinuar me zinxhirë dhe ornamente dekoruese.



Nostalgjia

Vitrinat e dyqaneve të sandaleve dhe këpucëve të pranverës 2026 reklamojnë një gamë modelesh të frymëzuara nga stili vintage. Sandale me lidhëse ose me gisht, transparente ose me shkëlqim, taka të holla dhe nallane, pra, të gjitha me një prekje nostalgjie, por gjithmonë të risjella në modelet ultra-moderne.

**SUGJERIMI I MUAJIT MARS
NGA MULTIBRAND**

"Cube Heel Slingback" nga Givenchy janë definicioni i elegancës moderne me një thyerje arkitekturore. Silueta e pastër në lëkurë të zeze me shkëlqim theksohet nga taka skulpturore në formë kubi me finiturë gold, duke krijuar një kontrast të sofistikuar dhe tejet chic.

**ICONIC
GEO BAG**

ASUKU MARI
Nga **T(LASSE**

Kjo çantë transformon çdo paraqitje. Me motivin ikonik të hartës dhe dizajnin e rafinuar, ajo shton menjëherë luks dhe elegancë në çdo look. Perfekte si për ditën ashtu edhe për mbrëmjen, një simbol i stilit modern dhe sofistikimit.



BUZË TË BUTA

Harrojeni buzët super të sakta dhe të vijëzuara - viti 2026 sjell buzëkuq me butësi sensuale, nga pigmentet transparente deri te teksturat prej kadifeje me shkëlqim të lartë. Për ta arritur këtë, aplikoni një buzëkuq mat në qendër të buzëve, pastaj shtyjeni butësisht ngjyrën nga jashtë duke përdorur gishtin, duke zbutur skajet. Ky stil shkon bukur me lëkurë të bronztë, faqe të skalitura butësisht dhe laps klasik për sytë.

SHKËLQIMI NË PLAN TË PARË

Sivjet trendet e bukurisë riafirmojnë dominimin e bazave me shkëlqim. Zgjidhni nuanca hibride për lëkurën, fondatina serum, formula që rrisin shkëlqimin dhe lejojnë që tekstura e vërtetë të duket. Balanconi zona të caktuara të fytyrës duke nxjerrë në pah efektin natyral, një funksion i cili thekson aspektin minimalist, qoftë për grimin e përditshëm, por edhe për atë të mbrëmjes.

NUANCA METALIKE

Ngjyrat e kromit, me shkëlqim dhe metalike rikthehen këtë vit, duke dhuruar një pamje të rafinuar drejt fantashkencës ose stilit diskotekë. Theksoni kapakët me një efekt reflektues ose cepat e brendshëm të syve me vija holografike, madje mund të vendosni sipër edhe një shtresë me perla ose kristale, një kombinim ideal mes grimit minimal me efektin kromatik.

THEKSO SYTË

Frymëzuar nga trashëgimia kulturore arabe dhe aziatike, theksimi i syve me vijëzues të zinj është një hap jo domosdoshmërisht dramatik, përkundrazi bart një ndjesi të theksuar sensualiteti. Vijëzoni qepallat duke i shtuar atyre intensitet dhe ekspresivitet, një stil me pamje rock që thekson më shumë bardhësinë e lëkurës, duke nxjerrë në pah më së shumti zonën e syve.

4 **Trende**
BUKURIE
për **2026-n**

Këtë vit tendencat e bukurisë zhvendosen drejt linjave të buta: nga buzët me shkëlqim të kadifenjtë te nuanca metalike, efekti natyral të fondatinës dhe vijëzues që nxjerrin në pah sytë.



JESHILE

Kjo jeshile kremoze e sherbelës me një nuancë gri përbën një trend joshës këtë sezon.

PINK

Thonjtë aura janë rikthyer duke nxjerrë në pah gjithë feminilitetin dhe delikatesën e ngjyrës rozë.

Ylber
mbi **THONJ**

Larmishmëri ngjyrash dhe stilesh propozojnë manikyristët për vitin 2026, por gjithmonë ka një trend që dallon. Mund të zgjidhni nuanca klasike si e kuqja, ose të luani me ngjyrat neutrale, po ashtu bluja dhe jeshilja e pyllit mbeten në krye të listës. Kombinimet ideale, efekti metalik dhe thonjtë gjysmëtransparente.

ROCK

Nuk është e zezë, por një nuancë e përzier me grinë dhe qymyrin, duke i dhënë thonjve shumë dramaticitet.

PAFUNDËSISHT BLU

Manikyri blu është misterioz dhe dramatik. Provoni nga bluja prusiane, ajo e errët apo nuanca të çelëta.

CLOUD DANCER

Pantone e shpalli ngjyra e vitit, por ngjyra e qumështit mund të kombinohet edhe me perla ose xixa.

GARNET NOIR

Thonjtë të kuq në nuanca të verës reflektojnë një pamje luksoze dhe të sofistikuar.


NGJYRA KAFE

Ngjyra kafe ishte hero i stilit dimëror, por tani nuanca me tonet e tokës përfshin çokolatën, mokën dhe lajthinë.



KASKETË

Prerja e flokëve kasketë sivjet vjen më moderne sesa versioni klasik, linja mbetet e pastër dhe kompakte, një pamje e cila kornizon fytyrën pa e prishur gjeometrinë e saj. Rezultati është i rregullt, elegant dhe dinamik. Ideal për fytyrat ovale dhe katrore, sepse zbut tiparet.



NGJYRAT

Tonet e ngrohta dhe natyrale, ngjyra kafe e ngrohtë, flokët me nuanca karamel, bionde mjalti do të rikthehen fuqishëm këtë sezon. Për ato që guxojnë e kuqe kanelle dhe bakri, janë më provokueset. Nëse jeni bionde, mund të eksperimentoni me nuancat platin me efekt metalik.

PLATIN METALIK

Rita Ora ishte pionere e ngjyrës platin me efekt metalik, një bionde super e ftohtë e cila dhuron dhe transmeton një pamje ultra-futuriste. Mund ta aplikoni me prerje të shkurtra ose rimodelime të gjata flokësh, të drejta ose me onde. Ideal për çdo lloj fytyre.

BALUKE E SHKURTËR

Një alternativë romantike, e cila rikthen stilin e viteve '90. Baluket e shkurtra mbi sy kanë aftësinë të dhurojnë për çdo grua pamjen e stilit "femme fatale". Kombinimi i balukeve të shkurtra me një prerje asimetrike krijon një aspekt të përsosur femëror.



PIXIE

Viti 2026 sjell një model më të butë pixie. Në thelb është një prerje e shkurtër, por pak e çrregullt, mund të përshtatet me çdo lloj nuance dhe mbetet ideale për ato vajza që duan një transformim radikal të look-ut. Ideal për fytyra të rumbullakëta.



VIJË NË MES

Ky model vjen nga vitet '60, por shumë më i butë; nxjerr në pah anën e butë dhe femërore. Një prerje simetrike, e cila përshtatet kryesisht me nuancat e tokës, e cila thekson fort tiparet e mprehta të fytyrës, ndaj sugjerohet për format ovale.

FLOKËT PAS SHPINE

Modeli i flokëve të hedhura totalisht pas shpinës ishin surpriza e pasarelave, një stil që reflekton një siluetë të fuqishme. Përpikuni t'u dhuroni flokëve një krehje të njëtrajtshme, jepini shumë shkëlqim për të nxjerrë në pah portretin tuaj. Ideal për fytyra ovale.

Trendet e flokëve për vitin 2026 reflektojnë modele prerjesh natyrale dhe linja të pastra. Pavarësisht nëse kenë flokë të drejtë, me onde apo kaçurrela, prerjet e reja synojnë një pamje spontane, e cila thekson një look sa më natyral. Mund të zgjidhni 6 modelet më IN të sezonit, nga kasketë tek ato të hedhura pas.

Prerjet
më **IN**
Të flokëve

Aromat e pranverës

Të blesh parfumin më të mirë nuk është një gjë e lehtë. Por, nëse ju duhet një i ri, zgjidhni gjithnjë një aromë të re. Sugjerimet e sezonit sjellin shumë lule të përziera me esenca drusore, myshk dhe agrume, të cilat kur bëhen bashkë dhurojnë një ndjesi herë delikate, e herë të thellë e cila i ngjan një flladi dehës pranveror. Ju mund të zgjidhni mes shumë sugjerimesh, disa nga parfimet më të mira për gra për vitin 2026.



TEA TONIQUE
Miller Harris
nga

ANAIS COSMETIC

Freskia e çajit jeshil në formën me elegante të saj. Agrume të cilat hapin aromën. Të balancuara me nota aromatike dhe drunore. I pastër, modern dhe subtil. Një parfum chic që lë një përshtypje të qetë, por të paharrueshme.



The Harmonist
Sacred Water
nga

EURO PARFUMERI

Parfumi Sacred Water është një harmoni agrumesh, lulesh dhe myshqesh të butë. Një aromë effortless që lartëson momentet e përditshme.





NATALIE PORTMAN

ELEGANCA E MENDJES

Nuk është aspak ai modaliteti i nënës që e mban të lidhur pas familjes, por fakti që ajo ka arritur sot në një fazë të karrierës kur duhet të zgjedhë një rol jo se i pëlqen, por sepse nuk i ngjan asaj. Natalie Portman, e njohur për brishtësinë dhe ngrohtësinë e jashtëzakonshme, sjell profilin jo vetëm të një aktoreje me përvojë, por edhe të një nëneje me dy fëmijë. Në moshën 44-vjeçare, Portman u divorcua nga burri i saj, dy vite më parë, pa ndaluar për asnjë çast punën në sheshxhirime. Ajo sapo përfundoi xhirimet e filmit “The Gallerist” i cili pritet të shfaqet sivjet në kinema, e duket se ky rikthim ndezi një luftë ofertash për projektet e ardhshme. Ylli i filmit “Black Swan” zbulon sesi ka arritur të ruajë jetën private, duke mbajtur median larg fëmijëve të saj. E diplomuar në Universitetin e Harvardit për Psikologji në 2003 dhe njohëse e 6 gjuhëve: anglisht, hebraisht, frëngjisht, gjermanisht, japonisht dhe arabisht, duket se asgjë nuk i ka zbehur dëshirën për të luajtur në film.

Sa e vlerëson bukurinë?

Që në moshë të re, isha e vetëdijshme për rreziqet e përqendrimit të tepërt të bukuria, sepse vija nga një sfond socialist me bindjen se çdo gjë fizike ishte sipërfaqësore. Ishte një pikëpamje shumë e shëndetshme për t’u pasur – një lloj antidoti për të jetuar në një botë ku i vihej kaq shumë rëndësi pamjes së jashtme. Por kur u bëra nënë, fillova ta vlerësoja si një mënyrë për të përkëdhelur veten, për t’u ndjerë mirë dhe joshëse.

Cili ka qenë transformimi juaj më i madh në film?

Një nga transformimet e mia më të njohura është në “Star Wars” si Mbretëresha e Madalës. Rruajtja e kokës për Vendetta ishte kaq çlirues. Ndërkohë, “Black Swan” ishte një transformim më i madh fizik, mjaft ekstrem për sa i përket arritjes në një pikë ku isha e fortë për të luajtur një balerinë.

Cili është sekret i juaj i bukurisë?

Kur bëhet fjalë për kujdesin e lëkurës, jam mjaft e thjeshtë. Së fundmi fillova të përdor produktet për të larë dhe hidratuar lëkurën. Zakonisht përdor vetëm sapun për fytirën dhe krem hidratues. Bëj masazhe një herë në muaj dhe jam vegane prej 15 vjetësh.

Kur zgjedh një film i jep më shumë rëndësi personazhit apo skenarit?

Ka gjëra që vijnë në momente të caktuara të jetës tënde dhe unë mësova nga aktoret më të mira se është e rëndësishme të shkosh me gëzim në sheshxhirim, sepse nëse çdo gjë e bën me dëshirë, edhe skenarët që nuk të pëlqejnë të bëjnë t’i duash, po ashtu edhe personazhin.

A ndodh që rolet dhe jeta jote personale ndikojnë në një moment?

Nuk funksionon gjithmonë, por ka raste kur ajo që ndodh në jetën time personale, ngjan si pjesë e një roli në film, sidomos kur bëhet fjalë për materiale të vështira emocionalisht. Kur luaj një personazh, padashje huazon një zë, gjeste, mënyrën e ecjes apo një theks, që të ngatërrohen pastaj me jetën reale dhe është e vështirë t’i heqësh qafe. Të kesh një pamje të ndryshme për një rol është e dobishme për të hyrë dhe dalë nga një personazh, kur je në gjendje të kthehesh te vetja. Është e rrezikshme të dukesh shumë si personazhi yt.

A ka diçka në jetën tuaj tani që të bën të entuziazmohesh?

Fëmijët e mi janë gjithmonë një burim emocionesh, sepse i shoh të zhvillohen çdo ditë. Gjithashtu, po kaloj së fundmi shumë kohë me miqtë e mi dhe familjet e tyre dhe kjo është mjaft argëtuese.

Çfarë i thua fëmijëve të tu, që prindërit nuk ta kanë thënë?

Edhe pse prindërit e mi gjithmonë më mbanin me këmbë në tokë, ata nuk m’i thonin të gjitha. Unë flas për gjithçka me fëmijët e mi, sepse askush nuk do ta thoshte të vërtetën përveç prindit. Miqtë janë gjithmonë të sjellshëm me ty, por nuk të thonë gjithçka. Shpesh duhet t’i themi fëmijëve edhe “Nuk është mirë kur e bën këtë”, për të kuptuar se si mund të jesh një person më i mirë.

Si arrin të jesh gjithmonë kaq pozitive dhe plot energji në sheshxhirim?

Sepse besoj që talenti nuk është gjithçka, thjesht duhet të jemi pak më shumë pozitivë, shumë të sjellshëm dhe të zgjuar, pasi kur xhirohet të gjithë nuk punojnë për ty, por për një projekt të përbashkët. Nuk mund të thuash kurrë “Unë jam më i veçantë”, por ne jemi më të mirë.

Pse gjithmonë vendos një filtër mbrojtës në raport me publikun?

Mendoj se publiku nuk ka pse të dijë si jam unë jashtë setit, por nga ana tjetër, kjo ka ardhur që kur isha më e re dhe papritur isha shumë e seksualizuar, gjë që u ndodh vajzave të reja që janë sot në ekran. Aty e ndjeva se mënyra ime për të mbrojtur veten ishte të isha shumë serioze. Mendova se nëse krijoj këtë imazh të vetes, do të lihem rehat nga media dhe funksionoi. Kur krijoja familjen vendosa një barrierë për botën, një kusht për median dhe një premtim që ia bëra vetes: “Nuk do të bëj sete fotografike me fëmijët e mi”.

Nëse nuk do të merresh me filmin, si do ta mbushje një ditë të zakonit?

Jo çdo ditë e imja është në sheshxhirim, ndaj kur jam e lirë, merrem me bletari. Kam pasur mundësi të udhëtoj në vende interesante dhe të takoj njerëz ku nuk kam pse luaj rolin e yllit të kinemasë. Mendoj se ka shumë gjëra të bukura në jetë që të japin emocione dhe dashuri.

Si lidheni me personazhet tuaja?

Sinqerisht, gjithmonë e kam urreyer këtë pyetje, sepse zakonisht jam më e interesuar të luaj dikë që është ndryshe nga unë. Sepse nëse është si unë, do të preferoja të jetoja jetën time.

Si e kuptove që do të bëheshe aktore?

U rrita në Long Island dhe meqenëse është afër Manhattanit, shumë fëmijë të moshës sime ishin në shkollën e vallëzimit me mua. Ata merrnin pjesë në audicione për reklama dhe për të fituar para për kolegjin. Kur u kërkova prindërve të mi nëse mundesha, ata nuk donin, derisa më lejuan por përmes një agjenti që të bëja audicion.

A mendon se marrëdhënia juaj me ambicien ka evoluar dhe ndryshuar?

Po, sepse isha shumë ambicioze si fëmijë dhe padyshim do ta përshkruaja veten si ambicioze edhe tani, por kjo ka ndryshuar plotësisht. Si fëmijë, isha shumë e interesuar të kënaqja njerëzit e tjerë, ndërsa tani, më pëlqen shumë të vendos sfida të reja për veten time, të kem përvoja të reja dhe të kënaqem për veten time.

L&M[®]
COMERCIAL

CASTELLO

NGA ITALIA TANI NË SHQIPËRI



“
CASTELLO ËSHTË NJË BIRRË E
LEHTË DHE E THJESHTË PËR T’U
KONSUMUAR. BIRRA E SAJ LOW KA
NJË PËRQINDJE TË ULËT ALKOOLI.
”

LAGJJA 14, RRUGA ASTI NUSHI
2007 SHKOZET, DURRËS

+355 52 420 565



Specialja e përvitshme e 8 Marsit vjen sërish me disa prej zonjave që janë pjesë e rëndësishme e jetës politike, sociale dhe artit në vend. Këtë herë na bashkohen personazhe si politikania Valentina Leskaj, inxhinieria Aurora Daja, producentja nga Kosova Linda Shala, gazetarja dhe drejtuesja e “Albanian Excellence”, Flora Nikolla, drejtuesja e Turizmit të Giz, Sofjola Kotelli, sopranoja Renisa Lacka, artistja Çiljeta Xhilaga dhe sipërmarrësj Romina Lula.

Valentina Leskaj

PËRTEJ POSTIT, NË SHËRBBIM TË VLERAVE

#NGA BRUNILDA GOROVELLI

#FOTOGRAFIA: ANDIS RADO

Në këtë numër të muajit mars, "Bordo" ndalet te disa profile zonjash shqiptare të suksesshme në fushat e tyre profesionale e, pa diskutim, të suksesshme edhe në jetë. Politika, media, shoqëria civile, muzika, arti, familja, të gjitha janë të lidhura drejtpërdrejt me jetët tona dhe me mënyrën si ne zgjedhim të kontribuojmë në shoqëri. Një nga këto figura është Valentina Leskaj, një grua që ka kaluar nga aktivizimi qytetar në politikën e lartë, për të vijuar sot angazhimin përtej posteve. Rrugëtimi i saj është dëshmi se suksesi nuk matet vetëm me tituj, por me ndikimin, integritetin dhe gjurmën që lë në jetën publike dhe atë personale.

Znj. Valentina si e përjeton politikën e sotme nga vendi ku ju para 8 vitesh e pozicionuat veten?

Edhe pse distante nga politika e ditës, një njeri që ka qenë për shumë vite brenda saj, mbetet një qenie politike çka do të thotë se e ndjek politikën. Unë kam qenë e angazhuar për një pjesë të mirë të jetës sime në shoqërinë civile e pastaj në politikë dhe nuk mund të jem indiferente ndaj asaj që ndodh në vendin tim e përtej tij.

Edhe pse jeni larguar nga politika aktive si vazhdon sot kontributi juaj?

Politika nuk është e kufizuar brenda gardhit të partive politike, ajo shkon përtej. Njeriu e gjen mënyrën për të kontribuar qoftë me një aktivitet, me një reagim publik, me një botim, apo angazhim tjetër etj. Vaclav Havel thoshte se "Edhe një koncert i muzikës rok është politikë" dhe ka të drejtë. A nuk ishte dhe rasti i Woodstock-ut në vitet '60, që pati ndikimin më të madh në të drejtat civile? Po le të kthehemi te një shembull konkret nga vendi ynë. Çfarë ishte rasti i protestës së shoqërisë civile kundër sjelljes së armëve kimike në Shqipëri? A është ky një model i forcës së ndikimit të vendimmarrjes së politikës nga shoqëria civile? Pa dyshim që po, sa kohë që qeveria vendosi të ndryshonte qëndrim dhe armët kimike nuk erdhën në Shqipëri. **Një ftesë për të qenë pjesë e politikës teksa ju ishit në Paris. Nëse ktheheni pas në kohë, çfarë e motivoi hyrjen tuaj në politikë pas viteve '90?**

Nuk ka qenë vendim i lehtë, siç e kam thënë edhe në librin tim të fundit, politika është vendi ku njeriu mund të humbasë një pjesë të vetes, ndoshta edhe atë pjesë që e quan më të çmuar. Nëse politikën e merr si përgjegjësi natyrisht që duhet ta mendosh mirë. Po

arsyet kanë qenë më shumë se një, kisha punuar për përfshirjen e grave në politikë dhe është e vështirë t'u kërkojë të tjerave ta bëjnë dhe të thuash unë jo. Kjo është çështje morale. Me organizatën që drejtoja kemi folur jo vetëm me fjalë e kritika ndaj partive, për gratë në politikë, po dhe me nisma konkrete. Me nismën time kemi ngritur të parën akademi politike për gratë dhe vajzat në Shqipëri, një pjesë e të cilave kanë konkurruar dhe janë zgjedhur në këshilla bashkiake deri dhe kryetare bashkie apo deputete. Ka patur edhe motivues të tjerë që më kanë nxitur të pranoj propozimin e PS-së. Mike të mijat nga lëvizja e gruas dhe përgjithësisht nga shoqëria civile që e kanë parë si një moment të përfshirjes dhe hapjes së politikës ndaj shoqërisë civile, më kanë motivuar që ta pranoja pozicionin e ministres së Punës e Çështjeve Sociale.

Cila pyetje nuk mori përgjigje që vendosët të largoheshit nga politika e ditës?

Arsyeja e tërheqjes nuk është vetëm një dhe padyshim që nuk lidhet me pyetje apo dilema personale. Ka qenë një vendim i ftohtë i menduar me kohë. Në fakt afërsisht një vit përpara se të largohesha kam folur në një emision me Xhaxhiun për largimin, po pa dyshim kam vazhduar përgjegjësitë deri ditët e fundit, madje duke kërkuar mbështetjen edhe për kandidatët për deputetë që do të më zëvendësonin. Arsyen e kam bërë të qartë në një deklaratë për shtyp ku kam thënë se kam vendosur të mos rikandidoj, për t'u hapur rrugë të rinjve në politikë, do të preferoja të më zëvendësonte një e re, mendoj se duhet t'u hapet rruga të rinjve, elitat duhet të rotohen. Ndërkohë kam thënë se kam vendosur të bëj një distancë të shëndetshme nga politika e ditës (besoj këtu merr përgjigje dhe pyetja juaj për dilemat) dhe mbetem njeri i angazhuar sepse politika për mua ka qenë angazhim jo vend pune. Besoj fort se njeri të angazhuar nuk të bën karrigia.

Si e vlerësoni rolin e grave në politikën shqiptare?

Në fakt rolet nuk i shoh të ndara sipas gjinisë. Një njeri mund të jetë i suksesshëm ose jo pavarësisht nga gjinia. Aq më pak e shoh rolin e gruas në politikë si çështje numrash, problemin nuk e zgjidhin numrat, të cilat nuk do të kishin vlerë pa meritokracinë e cila të çon te cilësia. Ne kemi luftuar bashkë (pozitiv-opozitiv), për të bërë kuotën gjinore në parlament, në kohën që gratë përbënin vetëm 6,7 (vitet 2005-2009). E bëmë sepse përfaqësimi është e drejtë njerëzore, gratë ishin të nënpërfaqësuar dhe nga ana tjetër nga kjo nuk humbasin vetëm gratë, por e gjithë shoqëria. Ndër-

kohë kuota është për të dyja gjinitë, nëse nesër do të kemi më pak burra në politikë, kjo gjithashtu do të bënte problem për shoqërinë. Po pa dyshim që roli i grave është kyç për zhvillim të qëndrueshëm të një vendi. Kur ka pabarazi ajo kthehet në një problem jo vetëm për gratë, por për të gjithë shoqërinë dhe për vetë zhvillimin e vendit. Jo rastësisht ka një lidhje reciproke mes fuqizimit të grave dhe nivelit të demokracisë dhe zhvillimit të një vendi. Të gjithë e dimë se vendet me nivel më të lartë përfaqësimi e respektimi të të drejtave njerëzore kanë një ekuilibër më të mirë gjinor e janë vende me standarde të larta demokracie dhe zhvillimi ekonomik e social.

A bën gabime përsëritëse politika shqiptare? Nëse po, cilat gabime përsërit?

Po dhe janë shumë. Një nga gjërat që përsëritet reflektohet te qasja kundër, kundër tjetrit, atij që ke përballë, çka ka bërë që qasja në politikë vijon të jetë jo alternative. Shpesh edhe retorika dhe aksioni politik janë në të njëjtën formë, po ajo gjuhë urrejtjeje, po ato protesta, e njëjta paaftësi për të ngritur një dialog politik për interesa afatgjata të vendit. Ku është oferta? Qasja politike nuk dominohet nga oferta po nga qasja kundër tjetrit.

Ju ka zhgënjyer politika?

Nuk e shoh bardhë e zi. Zhvillimet politike kanë dritëhijet e tyre me arritje dhe dështime. Shqipëria ka njohur zhvillime në shumë fusha, sidomos vitet e fundit dhe kjo pa dyshim edhe falë politikës po analiza është komplekse dhe do të donte një intervistë më vete nëse do t'i listoja.

Presidente në Forumin e OJF-së shqiptare, aktive në disa organizata ndërkombëtare, që lidhen me UNESCO-n apo OKB-në, CEI-n, zëvendësprezidente e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, reportere e Këshillit të Europës për Moldavinë dhe së fundmi anëtare në Bordin Këshillëdhënës të Lëvizjes Kundër AntiSemitizmit (CAM). Çdo të thotë për një grua shqiptare të jetë pjesë e lëvizjeve ndërkombëtare?

Është eksperiencë e vyer, përgjegjësi po natyrisht edhe një vlerësim, sidomos ishte në vitet e para, kur vendi ynë nuk njihej mirë ose kishte imazhin e valëve migratore të njerëzve që rrëmbenin anijet për të ikur. E kam hasur shpesh këtë, po gjërat kanë ndryshuar. Sot shqiptarët ndihen të barabartë si kontributorë kudo që të jenë në çdo institucion në çdo cep të globit.

Cili ka qenë momenti më i vështirë në jetën tuaj personale?

Humbja e bashkëshortit.

Çfarë kujtoni thuasje çdo ditë të tijen sot?

Kujtoj çdo gjë, deri tek ajo rutina e përditshme në një familje që funksionon, në një marrëdhënie dashurie e respekti. Ne ishim studentë kur u martuam dhe shumë të rinj, në një farë mënyre u rritëm e u formuam bashkë. Morëm shumë nga njëri-tjetri. Një nga ritualet ishte çaji që e pinim pasdite në orën 18:00, ritual që ishte i përditshëm sidomos kur unë ika nga politika, më përpara

rrallë ndodhte të isha në shtëpi në atë orë.

Çfarë ju bën sot realist të lumtur, larg protokollit dhe politikës?

Koha që kaloj me fëmijët, nipërit dhe mbesën e tani jam bërë edhe me një mbesë të vogël nga vajza e tim biri. Më shijon sidomos e diela që mbidhemi gjithë familja për drekë, se java është e ngarkuar për të gjithë, gjithsesi edhe gjatë javës e gjej mundësinë. Dashuria e familjes ma ka ndryshuar komplet cilësinë e jetës, përpiqem të kompensoj atë që kam humbur kur isha në politikë, që çdo fundjavë isha në zonën elektorale për të takuar njerëzit. Ndërkohë nuk jam e larguar prej aktivitetit, jam e ngarkuar edhe pse të një lloji tjetër, që nuk burojnë nga pozicioni politik, një pjesë e angazhimeve janë qysh prej vitit 1993, po edhe të pas largimit nga politika. Vazhdoj me pjesën e marrëdhënieve dhe aktivitete ndërkombëtare ku jam e zgjedhur, një pjesë ju i keni përmendur më lart, por edhe angazhime të tjera.

Cili ka qenë mësimi më i madh që ju ka dhënë dashuria?

Dashuria ka vlerë kur ka respektin për njëri-tjetrin në mes.

Çfarë keni trashëguar nga nëna dhe çfarë nga babai?

Babai im ishte i ndikuar nga frankofonia jo thjesht në gjuhë po edhe në marrëdhënien familjare, ishte liberal gjë jo e zakonshme për kohën, marrëdhënia e tij me nënën time ishte gjithashtu jo e zakonshme për kohën, kur burrat ishin autoritarë në familje. Nga nëna vetëpërmbytjen, po besoj gjithë çka jam.

Çfarë shihni nga vetja te fëmijët apo nipërit tuaj?

Natyrisht që kanë gjëra, nga unë dhe nga babai i tyre. Sa më shumë kalon koha aq më shumë gjen nga vetja po pa dyshim që është një brez tjetër, jemi tre breza që ecin me shpejtësi të ndryshme. Janë shumë më përpara, po besoj se kanë marrë më të mirën: edukimin, punën, respektin për tjetrin dhe pa dyshim modelin e familjes. Kur unë ju them që lërin pak më shumë kohë vetes për pushim dhe për të shijuar jetën thonë, vetë na ke mësuar ne na shijon kur punojmë. Nëse pranvera do të përfaqësonte një fazë të jetës suaj, në cilën pranverë ndodhemi sot, në atë të realitetit, të pjekurisë apo të paqes? Është një përzjerje.

Duhet të isha në atë të paqes, në fakt ende nuk jam aty. Jam e angazhuar dhe ende eci me agjendë ditore dhe shpesh e gjej veten të ngarkuar me shumë gjëra, po nuk është ndryshim i lehtë kur je mësuar me një ritëm! Nuk e kam arritur ende fazën e paqes që thoni ju, edhe pse ndonjëherë e dëshiroj.

Në këtë muaj që simbolizon forcën dhe dinjitetin e grave, cili është mesazhi juaj për vajzat dhe gratë shqiptare që sot përballen me sfida, por kanë ëndrra të mëdha?

Në fakt nuk e kam zakon të jap këshilla, po mendoj se në Shqipëri ka ndryshime të dukshme dhe arritje sa i takon të drejtave dhe integritetit të grave, po nuk duhen matur me Tiranën. Kemi ende një rrugë të gjatë për të bërë, derisa gratë të kenë të njëjtat të drejta e mundësi me gratë në vendet ku synojmë të integrohemi.



Aurora Daja

EVOLUCIONI I GRUAS PARIMORE!

#NGA OLSI KOLAMI

#FOTOGRAFIA: ANDIS RADO

Cdo grua që shohim në pikën e saj më të lartë të suksesit, na frymëzon dhe na tregojnë se me punë arrihet gjithçka. Ndodh që joshja për sukses të çon në vendime të shpejta dhe jo rrallë ka ndodhur që kostoja të jetë më e lartë sesa mundësia që kemi për ta paguar. Aurora Daja, me profesion inxhinieri, drejtuese e një transformimi real të Radio Televizionit Shqiptar, në më pak se një vit në krye të kësaj medie është modeli më i mirë për të treguar se nëse ndjek me dinjitet, devocion dhe vërtetësi hapat që ke marrë përsipër, ti jo vetëm e arrin qëllimin, por edhe e shijon atë!

Aurora, përshëndetje, mirë se erdhe në "Bordo". Si do ta përshkruanit rrugëtimin tuaj profesional deri këtu? Faleminderit për ftesën. Pjesa ime profesionale ka ecur mbi një rrugëtim të bazuar në punë, përpjekje dhe përgjegjësi! Kam qenë gjatë gjithë kohës me një lloj ndërgjegje dhe profesionalizëm për të bërë çdo gjë shumë mirë. Jo thjesht për të bërë mirë!

Cilat kujtoni momentet më vendimtare për ju?

Momentet vendimtare kanë qenë ato momente kur unë duhet të vendosja për të marrë një vendim shumë të rëndësishëm, drejtimin e një institucioni publik, siç është Radio Televizioni Shqiptar. Ai ishte momenti më i vështirë dhe vendimi më i vështirë imi, të cilin e pranova sa me gëzim brenda vetes, aq edhe me përgjegjësi shumë të madhe për një detyrë aq të rëndësishme që mu ngarkua.

Dhe me ngarkimin e kësaj detyre kaq të rëndësishme vjen dhe një presion shumë i madh. Si e menaxhuat ju? Kjo ishte pjesa më sfiduese. Të menaxhosh me presion punën do një durim të cilin besoj se unë e kam. Unë kam një përgjegjshmëri të madhe në punë. Mendoj se në qoftë

se ti ke disa parime ti nuk ke frikë nga ato trysni të cilat i ke gjatë punës. Nëse këto parime ti nuk i humbet gjatë rrugës, ti mund ta menaxhosh shumë mirë pjesën e trysnisë që të vjen pas punës.

Si e shihni sot rolin e medias publike në një kohë kur rrjetet sociale janë ato që po ndryshojnë gjithçka?

Në këto momente, kur media sociale është shumë e shpejtë në hedhjen e të dhënave apo të lajmit, për sa i përket medias publike sidomos është shumë e vështirë dhe do një punë profesionale për të hedhur lajmin sa më të saktë, sa më të përgjegjshëm dhe sa më real. Mendoj në disa raste puna e medias publike është shumë më e vështirë. Vetëm duke pasur disa parime, mbi të cilat duhet të ecë çdo gazetar për të dhënë një lajm sa më të saktë dhe të dominojë mbi lajmin e medias sociale.

Cilat kanë qenë vlerat kryesore që ju kanë udhëhequr në punën tuaj?

Dinjteti, kryesorja, përgjegjshmëria dhe karakteri i durimit. Këto mendoj unë që kanë qenë tri gjërat kryesore të mia të cilat më kanë udhëhequr në drejtimin e punës sime.

Si i keni balancuar përgjegjësitë e mëdha në profesion me jetën personale, familjare?

Duke i kombinuar të dyja! Duke mos lënë hapësirë bosh edhe për familjen, e cila është një pjesë kryesore jona, ashtu edhe me pjesën e punës. Jam munduar që t'i kem të balancuar të dyja. Ndoshta në periudhën kur kam qenë dhe drejtuese, kam lënë pak nga pjesa e familjes duke iu përkushtuar më shumë punës.

Çfarë këshille do t'u jepni të rinjve që duan sot të ndërtojnë një karrierë në media?

Duhet patjetër të studiojnë shumë, të mos mendojnë që karriera është e menjëhershme. Karriera do durim, duhet





*Ti mund TË
NGJITESH avash-
avash atje ku DUHET
në karrierën tënde
që KËRKON, jo ta
kalosh me shpejtësi
pa e kuptuar dhe
PËRJETUAR as ti vetë
rritjen profesionale.
Ka shumë TË RINJ që
i shoh që direkt sapo
DALIN nga bankat
e shkollës DUAN të
bëjnë një KARRIERË
të shpejtë, të nxituar.
Jo, karriera MENDOJ
dhe kështu është,
ka një lloj kohe për
të kaluar nga një
shkallë në tjetrën!*



të jetë e fortë dhe që të jetë e fortë duhet të jetë me shkallë, domethënë jo e menjëhershme. Ti mund të ngjitesh avash-avash atje ku duhet në karrierën tënde që kërkon, jo ta kalosh me shpejtësi pa e kuptuar dhe përjetuar as ti vetë rritjen profesionale. Ka shumë të rinj që i shoh që direkt sapo dalin nga bankat e shkollës duan të bëjnë një karrierë të shpejtë, të nxituar. Jo, karriera mendoj dhe kështu është, ka një lloj kohe për të kaluar nga një shkallë në tjetrën!

Çfarë cilësish duhet të ketë dikush që ju ta punësoni?

Cilësitë e para duhet të jetë i sinqertë, duhet të ketë një karakter të fortë, të jetë i përgjegjshëm për atë që bën. Këto janë tri besoj gjërat kryesore që një person duhet t'i ketë në punë. Përgjegjësia është kryesorja te pjesa që merr dhe duhet ta bëjmë me shumë përgjegjësi atë gjë që merr edhe jepet për ta drejtuar, për të menaxhuar edhe veten.

Te një punonjës shikoni më shumë përvojën apo karakterin?

Pa diskutim karakterin. Karakteri nuk ndryshon. Përvoja merret siç e thashë dhe në fillim, avash-avash ti do t'i marrësh përvojën dhe do ta zbatosh, do ta bësh në punë atë gjë që ti e ke përfituar me vitet.

Si e dalloni një profesionist të mirë që në takimin e parë?

Atë e njeh që në momentin që bisedon me të, nga mënyra se si diskuton dhe nga koha që të kushton gjatë bisedës së intervistës për punë.

A keni një rutinë ose zakon që ju ndihmon të jeni e fokusuar dhe energjike për të vazhduar përpara?

Padiskutim! E para është organizimi i gjërave që duhet të bëj, përkushtimi dhe mendoj që gjithmonë i rikthehem gjërave që duhet të rregulloj, që t'i kem edhe më mirë për ditën tjetër. Këto janë parimet e mia.

Çfarë ju jep më shumë kënaqësi jashtë punës?

Familja, shoqëria ime të cilën nuk e humb në asnjë moment edhe kur unë jam e ngarkuar me punët e mia, mundohem të lë pak hapësirë edhe për të kaluar një pjesë të kohës së mirë me shoqërinë dhe me familjen.

Si e kujtoni momentin kur ndjetë se po arrinit diçka të rëndësishme si grua dhe si profesioniste?

Në momentin që duhet të merrja disa vendimmarrje të rëndësishme reale, mendoj që ka qenë pjesa më e rëndësishme e imja si grua, si femër dhe jam munduar që të jem shumë e sinqertë në atë që bëj dhe në atë vendimmarrje që unë do të që merrja dhe e marr gjithmonë. Gjithmonë mendoj shumë gjatë diçka kur marr vendime, përpiqem t'i marr ato me profesionalizëm, duke mos lënduar njeri, por ndërkohë dhe duke ruajtur ato të cilat mua më kërkohen për të marrë një vendimmarrje në të mirë të punës dhe profesionalizmit.

A ka pasur role femërore në familje ose në shoqërinë tuaj që ju kanë inspiruar gjatë rrugëtimit tuaj?

Pa diskutim që ka, Shqipëria ka treguar që ka shumë femra të forta. Më kanë inspiruar përgjithësisht femrat e forta. Ato janë frymëzimi im.

Vajzës suaj, cila është këshilla që i thoni më shpesh?

Të ketë besim te vetja. Është kryesorja. Vetëm ashtu do të ecë përpara, duke ruajtur gjithmonë dinjitetin, të mos humbasë asnjë moment dhe të jetë e sinqertë në atë çfarë bën.

Në jetë keni marrë mirënjohjen e duhur për gjërat që keni dhënë?

Jo gjithmonë, por në përgjithësi e kam marrë edhe mirënjohjen.

Cilat janë vlerat në të cilat ju besoni më shumë?

Dinjiteti, përgjegjshmëria, sinqeriteti janë kryesoret për të ecur përpara. Janë vlera, që duhet t'i ketë parasysh çdo i ri!

Sofjola Kotelli

BESOJ TE MATORIA DHE FUQIA E SINERGJISE

#NGA ILDA LUMANI

#FOTOGRAFIA: ANDIS RADO

Në karrierën time si gazetare kam takuar dhe njohur profesionistë, njerëz të matur, me eksperiencë dhe modele, që vlejnjë jo vetëm për t'i pasur afër, por edhe për t'u frymëzuar. Një prej tyre është padyshim Sofjola Kotelli, drejtuese e Turizmit në GIZ Shqipëri, një grua, që nuk të duhet një njohje e thellë dhe e gjatë në kohë. Prezantimi me të e mandej takimet e pakta për punë, më kanë dhënë një ndjenjë pozitive dhe motivuese. Me një eksperiencë që nis nga media e shkruar, në Selanik, teksa ajo ishte studente, te përfshirja e saj në bashkinë Korçë, ku puna e saj dhe ekipit me të cilin punonte la një shenjë për atë që qyteti juglindor është edhe sot; më tej puna pranë qeverisë, e vitet e fundit përkushtimi i saj në promovimin, evidentimin dhe përmirësimin e turizmit rural janë dëshmi e një njeriu pasionant, të përkushtuar, që beson te sukcesi i punës në grup. Kombinuar kjo me përkushtimin familjar, Sofjola ndan me lexuesit e "Bordo" rrugëtimin e saj, i cili vlen të lexohet edhe si një leksion për të gjithë të rinjtë!

Sofjola, mirësevjen në BORDO. Cili është impakti yt përballë një reviste, duke qenë se ti vetë ke drejtuar një revistë dikur?

Revista është dashuria ime e parë me punën. Ishte fillimi im në aspektin profesional dhe një fillim shumë i bukur. Isha ende studente, në periudhën kur vazhdoja Masterin për Administrim Biznesi në Selanik, kur drejtova revistën "Prestige". Ishte një revistë e vogël, por me një mision të rëndësishëm, revista e parë shqiptare në Greqi, një hapësirë e dashur për emigrantët shqiptarë. Ajo eksperiencë më mësoi shumë mbi komunikimin, përgjegjësinë dhe fuqinë që ka fjala e shkruar për të krijuar komunitet dhe për të dhënë zë.

Të vjen keq që nuk e vazhdove atë pasion? Dhe nëse do ta kishe vijuar, ku do ta shihje veten sot? Në median e shkruar apo në ekran?

Të jem e sinqertë, jo, nuk më vjen keq. Që në fillim isha e qartë me veten: ishte një pasion dhe një angazhim për një moment të caktuar të jetës sime. Edhe pse kam jetuar jashtë gjatë studimeve universitare dhe pasuniversitare dhe rrugëtimi im profesional nuk ishte i kristalizuar, për një gjë kam qenë gjithmonë e sigurt do të kthehesha në Shqipëri menjëherë pas studimeve. Ndoshta pikërisht kjo qartësi më lidhi me median e shkruar vetëm përkohësisht. Ishte një kapitull i bukur, por jo destinacioni im përfundimtar.

Sot je drejtuese e turizmit në GIZ Shqipëri. Si është ky moment karriere për ty?

Drejtimi i turizmit rural, puna me agro-turizmet, bujtinat e vogla, prodhuesit e vegjël, me të rinjtë që promovojnë turizmin e eksperiencave dhe aventurës, destinacionet e reja akoma të pazbuluara, më japin një kënaqësi të veçantë. Ndjehem me fat që prek nga afër histori të vërteta, njerëz që, pavarësisht sfidave e vështirësive, kanë arritur të ndërtojnë diçka me vlerë në zonat ku jetojnë për veten dhe komunitetet. Janë pikërisht këta njerëz modelet e vërteta dhe frymëzimi im i përditshëm. Përmes punës kam udhëtuar cep më cep në Shqipëri, kam ndaluar në fshatra të vegjël malorë, në zona të thella rurale, në bregdet e në luginë ku jeta rrjedh me ritmin e saj të vërtetë. Kam prekur nga afër autenticitetin tonë, atë që historia, koha dhe njerëzit kanë ndërtuar ndër shekuj me durim, sakrificë dhe dashuri për tokën e tyre. Kam takuar familje që ruajnë receta të trashëguara brez pas brezi, artizanë që vazhdojnë zanate të vjetra, të rinj që janë kthyer në vendlindje për të investuar në bujtina apo ferma të vogla, duke i dhënë një dimension të ri traditës. Në çdo cep të Shqipërisë ka një histori që pret të dëgjohet dhe një vlerë që pret të jetësohet. Nuk ka kënaqësi më të madhe sesa të ndihmohet këto histori dhe këto komunitete të dalin në pah, të pozicionohen siç duhet në zinxhirin e turizmit shqiptar dhe të marrin atë që meritojnë, jo vetëm në aspektin ekonomik, por edhe në dinjitetin dhe krenarinë për atë që përfaqësojnë. Autenticiteti, rrënjët tona, historia, këto janë thelbi i një kombi. Janë identiteti ynë dhe diferenca jonë. Në një botë ku gjithçka po uniformizohet, pikërisht ajo që është e vërtetë, e papërsëritshme dhe e lidhur me rrënjët bëhet vlerë dhe luks. Të kontribuoj që ky autenticitet të zërë vendin që meriton në turizmin shqiptar, të ndihmoj që zonat e ndryshme të ringjallen ekonomikisht, që komunitetet të krijojnë mundësi reale për zhvillim dhe për të ardhmen e fëmijëve të tyre, kjo padiskutim më frymëzon çdo ditë.

Cilat janë synimet dhe planet për vitin 2026?

Viti 2026 ka nisur vrullshëm. Kam synime dhe plane si në aspektin profesional, ashtu edhe në atë familjar. Profesionalisht, nisim një projekt të ri për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe turizmit pranë natyrës në Parkun Kombëtar të Vjosës, një zonë fantastike me potencial të jashtëzakonshëm e njerëz të mrekullueshëm. Unë besoj gjithmonë se fillimi i mbarë është gjysma e punës, ndaj ky vit do të jetë një shenjë e rëndësishme në këtë drejtim. Në aspektin familjar gjithashtu priten disa ndryshime, disa lëvizje që do të sjellin një rutinë të re. Besoj dhe shpresoj për mirë.



Eksperiencia në administratë është një tjetër pikë e fortë në karrierën tënde. Si e kujton sot atë periudhë?

Eksperiencia 11-vjeçare në qeverisjen lokale dhe qendrore është një nga shtyllat e forta të karrierës sime.

Në Bashkinë e Korçës (2008–2013) pata fatin të jem pjesë e një periudhe kur qyteti kishte nevojë për ide të reja, rigjallërim dhe orientim të ri. Ishte një kohë shumë e bukur, kur së bashku me njerëz të apasionuar ndërtuam profilin turistik të Korçës, një nga qytetet e para që i tregoi Shqipërisë se Shqipëria është e bukur për t'u vizituar nga vetë shqiptarët. Jam krenare që shumë prej ideve dhe projekteve të atyre viteve vazhdojnë të qëndrojnë fort edhe sot dhe janë bërë pjesë e identitetit të qytetit. Në qeverisjen qendrore mësova mbi të gjitha rëndësinë e njohjes së realitetit në terren. Politikat dhe strategjitë mund të duken shumë të mira në letër, por nëse nuk mbështeten mbi një kuptim të vërtetë të nevojave të njerëzve dhe specifikave të territorit, ato mbeten të mangëta. Qeverisja e mirë nis nga dëgjimi nga aftësia për të kuptuar, për të reflektuar dhe për të qenë i lidhur vazhdimisht me realitetin që synon të ndikosh.

Aty kuptova gjithashtu se çdo vendim, sado teknik apo administrativ të duket, ka impakt në shkallë të gjerë. Një vendim i mirë mund të krijojë mundësi, zhvillim dhe besim. Një vendim i nxituar ose i pamenduar mirë mund të prodhojë pasoja që shtrihen përtej një sektori apo një periudhe të caktuar kohe. Kjo më mësoi të jem më e matur, të mos nxitohem dhe të peshoj çdo hap me përgjegjësi. Një tjetër mësim i rëndësishëm ishte fuqia e sinergjisë. Asnjë institucion, asnjë ekip dhe asnjë individ nuk arrin rezultate të qëndrueshme i vetëm. Bashkëpunimi mes institucioneve, mes niveleve të ndryshme të qeverisjes, por edhe mes sektorit publik dhe atij privat, është çelësi i suksesit. Të punuarit i veçuar rrallë të çon larg; ndërsa kur krijohet një vizion i përbashkët dhe një koordinim i mirë, rezultatet janë jo vetëm më të dukshme, por edhe më të qëndrueshme në kohë. Këto mësimet i mbaj me vete edhe sot: të dëgjoj më shumë, të veproj me maturi dhe të ndërtoj ura.

Mes këtyre tre momenteve të karrierës, cilën eksperiencë veçon?

Secili moment ka pasur sfidat, kënaqësitë dhe mësimet e veta. Revista më mësoi rëndësinë e komunikimit dhe sidomos atë të produktit që komunikon. Komunikimi pa produkt të vërtetë dhe të mirëmenduar zbehet shumë shpejt. Bashkia e Korçës më forcoi lidhjen me qytetin tim, më nxiti kreativitetin e lidhjen me të shkuarën, dhe më mësoi këmbënguljen. Eksperiencia në nivel qendror më zgjeroi perspektivën dhe rrjetin e bashkëpunimeve, gjithashtu më ka plotësuar perspektivën, rrjetin e bashkëpunimeve dhe pritshmëritë. Puna që bëj sot më ka zhvilluar “të dëgjuarit”, të qëndruarit me këmbë në tokë, si dhe më mësoi se puna e mirë dhe rezultatet vijnë edhe në balancë të plotë me jetën personale, familjen dhe kohën që duhet t'i kushtosh vetes tënde çdo ditë.



Nuk kam qenë gjithmonë e suksesshme në këtë drejtim, por jam përmirësuar shumë me kalimin e kohës. Sot që flasim për mua, puna është shumë e rëndësishme dhe e bëj me përkushtim maksimal, por familja mbetet prioriteti im absolut. Mundohem që sfidat apo presioni i profesionit të mos ndikojnë në harmoninë familjare.

Nuk dua të veçoj asnjërën dhe as tjetrën. Realisht mendoj se edhe falë të gjitha këtyre eksperiencave dhe gërshetimeve në kohë të ndryshme, pas 20 vitesh unë jam kjo që jam sot. Dhe sigurisht kam shumë akoma për të mësuar, kontribuar dhe rritur profesionalisht dhe personalisht.

Familja jote sa pranë është aktivitetit tënd profesional? Apo puna punë dhe familja familje?

Familja ime është padyshim gjëja më e çmuar që kam ndërtuar në jetë. Është baza ime, forca ime dhe vendi ku gjithmonë gjej mbështetje, pavarësisht sfidave që më sjell angazhimi profesional. Ata janë njerëzit që më njohin më mirë se kushdo tjetër, që më qëndrojnë pranë pa kushte dhe që më japin forcë edhe në momentet më të vështira. Sa i përket raportit mes familjes dhe punës, përpiqem gjithmonë të ruaj një ekuilibër të shëndetshëm. Nuk kam qenë gjithmonë e suksesshme në këtë drejtim,

por jam përmirësuar shumë me kalimin e kohës. Sot që flasim për mua, puna është shumë e rëndësishme dhe e bëj me përkushtim maksimal, por familja mbetet prioriteti im absolut. Mundohem që sfidat apo presioni i profesionit të mos ndikojnë në harmoninë familjare. Them se e kam kuptuar se kujtimet që kanë vlerë të përrjetshme lidhen vetëm me familjen dhe njerëzit e dashur. Në të njëjtën kohë, ata janë shumë pranë aktivitetit tim profesional në kuptimin e mbështetjes morale. Këshillat e tyre, këndvështrimi i sinqertë më ndihmojnë të qëndroj me këmbë në tokë. Pra, për mua nuk është “puna punë dhe familja familje” në kuptimin e ndarjes së ftohtë, por është një balancë e ndërtuar me vetëdije, secila me rol thelbësor në përbushjen e vetvetes profesionalisht dhe personalisht.

Vajza jote si e sheh punën dhe profesionin tënd? Është e frymëzuar për të ndjekur të njëjtën rrugë?

Vajza ime, Noemi, e sheh punën time me një kuriozitet të bukur dhe me një vlerësim që më prek. Ne flasim për shumë gjëra, jo gjithmonë për punën time, por unë e ndiej që ajo e respekton atë që bëj. Ndonjëherë ndiej edhe krenarinë e saj të heshtur, ato momente të vogla, por shumë domethënëse për mua si prind. Nuk e di ende nëse do të ndjekë të njëjtën rrugë. Deri tani duket më e orientuar

drejt shkencave, por është herët për ta përcaktuar. Sinqerisht, për mua nuk ka rëndësi çfarë profesioni do të zgjedhë. Ajo që ka rëndësi është si do ta ndjekë rrugën e saj – me pasion, përkushtim dhe përgjegjësi. Do të doja që prej meje të marrë modelin e dashurisë për punën dhe seriozitetin, edhe për gjërat që nuk duken apo nuk marrin duartrokkitje. Sepse diferencën në jetë nuk e bën thjesht profesioni që zgjedh, por mënyra si e jeton atë. Nëse një ditë frymëzohet nga rruga ime, do të jem e lumtur. Por do të jem po aq e lumtur nëse ajo ndërton një rrugë krejt të sajën mjafton ta bëjë me zemër, integritet dhe përgjegjësi.

Flora Nikolla

GAZETARIA SI MISIION

#NGA BRUNILDA GOROVELLI

#FOTOGRAFIA: ANDIS RADO

Flora Nikolla është një nga ato gra që e kanë ndërtuar jetën mbi fjalën, etikën dhe dashurinë për vendin. E rritur mes korifenjve të letrave shqipe dhe e formuar në një familje ku gazetaria ishte mision, ajo e nisi rrugëtimin e saj në vitet '90 me një busull të qartë: të vërtetën. Sot, përtej projekteve madhore si “Albanian Excellence”, ajo mbetet një grua që beson te mirësia, te forca e trashëgimisë familjare dhe te vlera e punës së ndershme. Në këtë intervistë për “Bordo”, Flora Nikolla rrëfen fillesat, prindërit, dashurinë për gazetarinë dhe pasionin që e mban ende në lëvizje.

Si e kujtoni fillimin tuaj në gazetari në vitet '90? Të jeni gazetare ndikoi edhe babai juaj?

Të qenit gazetare është të sjellësh zërin e të tjerëve me fjalë të qarta, të ndjekësh të vërtetën me kurajë dhe të ndriçosh rrugët që të tjerët i kanë harruar. Babai im thoshte ‘gazetaria është një furrë e madhe që të djeg çdo gjë dhe në fund të le vetëm pasionin’. De facto e kam nisur gazetarinë që fëmijë sepse leksionet e dijet e mia për këtë profesion, i kam marrë duke dëgjuar mjeshtrë të mëdhenj të zanatit të të shkruarit në Shqipëri, si Petro Marko, Dritëro Agolli, Shefqet Musaraj, Sabri Godo, Todi Lubonja, Vangjush Gambeta, e kur shkoja në Pogradec në behar edhe nga Lasgush Poradeci. Unë isha një simbiozë me babain tim e doja të rrija që e vogël pa kushte më të dhe me miqtë e tij, që njëherazi ishin bërë pjesë e familjes sonë. Unë isha arrakate, doja të isha e lirë në lojërat e mia, por sapo kuptoja që në shtëpi do të shtrohej një darkë apo do të shkonim në një nga shtëpitë e miqve të babait, apo qoftë edhe në një piknik që në kohën kur im atë punonte në gazetën “Zëri i Popullit”, më ishte bërë ritual i zakonshëm, harroja çdo gjë e me padurim prisja orën e madhe. Qëndrimi me orë të tëra me këta korifenj të zanatit të të shkruarit dhe vëmendja ime absolute në këtë ‘auditor’ më mësoi konceptimin, mënyrën



e të menduarit. Indirekt mësova këtë zanat që e konsideroj idealin më të bukur të jetës sime, që e ruajta si gjënë më të çmuar e të cilin asnjëherë as e shita dhe as bëra biznes më të. Pas viteve '90 kur e nisa këtë udhë, isha e formuar në etikë profesionale, kisha kuptuar nga babai im që drejtoi për 25 vite një nga revistat më të vështira për atë kohë, siç ishte “Hosteni”, se sa rëndësi kishte e vërteta dhe saktësia, sa vlerë kishte verifikimi i fakteve para publikimit. (Im atë thoshte, se gazetari i zot gjithnjë duhet të ketë 3 burime, 2 ti botojë dhe një ta ketë mënjandë). Kujtoj po ashtu, një

konkurs të realizuar në vitin '90 në revistën "Shqipëria sot", fitova dhe u emërova redaktore. Por, cili ishte kryeredaktori im? Arqile Aleks, ish-drejtor i Agjencisë Telegrafike Shqiptare, mik i tim atë, një nga ata burrat simpatikë e plot mend të asaj kohe që gjithmonë i ulesha pranë gjunjëve, se doja t'i kisha të gjithë përballë e t'i shihja të gjithë çka bisedonin. Bashkëpunimi me shtëpinë botuese "Naim Frashëri", rikthimi sërish në Agjencinë Telegrafike Shqiptare, ku krijova departamentin e Kulturës dhe Sociales në ATSH në vitin 1998, një eksperiencë e jashtëzakonshme, ku janë formuar gazetarë shumë të mirë. Asnjëherë nuk iu ndava terrenit, duke ndjekur hap pas hapi ngjarjet e rënda të vitit 1997, apo luftën e Kosovës nisje-mbarim dëbimin më të madh të shqiptarëve në një fundshekulli. Kam raportuar direkt ngjarjet e luftës qytetare në Maqedoninë e Veriut në 2001, një guxim sërish i marrë, kur mendoj se isha përfaqësuese e agjencisë shqiptare në një vend ku po luftoheshin shqiptarët.

Këshilla që keni marrë nga babai dhe që e zbatoni çdo ditë?
Niko Nikolla, ishte një idealist i madh dhe një njeri me zemër të madhe, me një zgjuarsi që rrallë pak e kam hasur në këtë jetë dhe këtu nuk flas si për babain tim, por si koleg, pasi sot kam të drejtë morale dhe profesionale, ta konsideroj të tillë. Postulatet e tij për gazetarinë më ndjekin në çdo punë që bëj, duke i patur si mbrojtëse këtu në Shqipërinë tonë që nuk është aspak e lehtë të punosh... "Gazetari duhet të jetë me duar të pastra, mendje të kthjellët dhe zemër të ngrohtë", ose "Në një profesion duhet të dish kur të hysh dhe të dish kur të dalësh". Shpesh më thoshte: "Gazetari duhet të jetë patriot. Gazetari duhet të dojë vendin e tij, nuk mund të jetë gazetar i zoti ai që nuk di të dojë vendin e tij".

Po nga mamaja, çfarë keni marrë?

Them se kam marrë nga nëna ime, dëshirën e madhe për të ndihmuar dhe mbështetur njerëzit kur janë në momente të vështira. Por, edhe nderimin e respektin që u bëj njerëzve me "Albanian Excellence". Një pjesë është dhe shpirti i madh që kishte Margarita Pano, e cila si mua ashtu edhe motrën time na mësoi të ishim të lira, të jetonim pa diktat, pa i bërë kurrësi keq të tjerëve, parim bazë i familjes sonë, gjë e ndjekim në çdo hap dhe sot.

Si lindi ideja e krijimit të "Albanian Excellence"?

Lindi vetiu në vitin 2012, kur do të festohej 100-vjetori i themelimit të shtetit shqiptar dhe kur të gjithëve na kishte kapur euforia e kësaj ngjarje. Mendoja të hapja një cikël me intervista me shqiptarët e suksesit në botë, dukej se askush nuk e kthente vëmendjen nga ata. Në atë kohë kishte vetëm disa intervista sporadike në shtyp dhe kaq. Mendova se kishte ardhur koha të krijoja diçka timen e ta rrisja vetë. Kështu lindi "Albanian Excellence", mbi një strukturë të qartë mendimi që ishte, realizimi i një libri me intervista me shqiptarët e suksesit kudo janë, promovimi i librit në një mbrëmje Gala, shoqëruar me një lëvizje shoqërore të organizuar nga vetë historitë e suksesit në vendin e tyre. U realizua mbrëmja e parë Gala në Tiranë, më 23 nëntor 2012, 100 histori suksesi në 100-vjetorin e Shqipërisë. Më pas u botua libri "Zonjat shqiptare në Nju-Jork", 2016, i cili u promovua në Manhattan, me prezencën e Presidentit të asaj kohe të ndjerit, zotit Bujar Nishani, ku u nënshkrua dhe memorandumimi "Të qenit grua në shekullin XXI", më pas me siglën e "Albanian Excellence" do të botohej libri "121 histori suksesi në 121 foto", promovuar

në Presidencën shqiptare dhe në të gjitha trojet kombëtare edhe me një ekspozitë me 121 foto e zonjave të suksesit. E kështu kemi vijuar me ideimin dhe realizimin e "Lider në kohë pandemic", "Hero Covid 19", shoqëruar me botimin e një libri me intervista dhe mbrëmje Gala.

Cili është suksesi më domethënës i kësaj nisme deri tani?
Është shumë e shkurtër kjo përgjigje por shumë domethënëse, krijimi i një modeli të ri në shoqërinë shqiptare, emancipimi përmes suksesit të shoqërisë, dhënia e më të mirës së kombit tonë. Gazetaria ime tani është bërë një botë e madhe, brenda së cilës, idej, ndërtoj, realizoj nga A-ja deri te Zh-ja... dhe kjo falë asaj shkolle që kam mësuar nga fëmijëria ime e në çdo minutë të punës sime.

Çfarë projektësh po përgatit "Albanian Excellence"?

Viti 2026, do të jetë viti i Zonjave të suksesit shqiptar, sepse pas një pune me sukses në 10 vite nga nënshkrimi i Memorandumit, "Të qenit grua në shekullin e XXI", ka ardhur momenti të krijohet një klub vlerash të vërteta me zonjat e suksesit kudo në botë. Në këtë kuadër është përcaktuar një kalendar me aktivitete për këtë klub, i cili jam e sigurt nuk do të jetë fasadë, por një kontribut real i zonjave të ekselencës shqiptare. Viti 2026, është edhe viti i Bienales së Katërt Ndërkombëtar të Karikaturës Niko Nikolla, e cila për fat të mirë e futi Shqipërinë në vitin 2020 në hartën e karikaturës botërore. Këtë vit, ky aktivitet do të zhvillohet në fund të tetorit në Korçë, një qytet me një kulturë të madhe e mikpritje të ngrohtë dhe mendoj që në këtë Bienale, numri i shteteve që do të prezantojnë punët e tyre enkas për Shqipërinë, do ta kalojë numrin 100.

Sa e vështirë është të jeni grua drejtuese në media?

Kësaj pyetjeje do t'i përgjigjem sërish me një shprehje të Niko Nikollës, në botë ka tre lloj njerëzish: të mirë, të këqij dhe gazetarë..., unë mendoj se hyj te gazetarët dhe ata të vërtetët që përballë punës, nuk merr parasysh asgjë që mund të dalë përpara. Kur Niko Nikolla, ishte në koma, një natë të ftohtë e plot shi, fund dhjetori i vitit 2005, trokita në derën e drejtorit të ATSH-së në atë kohë, Edi Paloka. Sigurisht që ishim shokë, por gjithnjë kam ditur të ndaj jetën reale me profesionin, ndaj doja ta pyesja nëse mund të shkruaja lajmin e ikjes së babait tim, kur ai të mbyllte sytë, vetë unë. Mëngjesin e 4 janarit 2006, unë isha në tavolinën time të punës në ATSH, duke shkruar lajmin e ikjes së atit tim, krejt e ftohtë pavarësisht se zemra më kullonte lot. Doja që shkrimi i ikjes së atit tim, të ishte perfekt, pa asnjë gabim, pa asnjë lajthitje si i quante të pakorrektat e shkrimeve, ndoshta doja t'i tregoja se unë kisha plotësuar një premtim që i kisha dhënë. E tregova këtë ngjarje njerëzore, se kam qenë e jam e fortë përballë çdo vështirësie.

Çfarë do të donit të mbetej pas emrit Flora Nikolla?

Do të desha të më kujtonin për pasionin, dashurinë ideale që pata për të ndërtuar një gazetari të mirë në Shqipëri, me parime dhe etikë, se punova shumë të ndërtoja një model të ri në shoqërinë tonë me "Albanian Excellence" dhe se e desha në asht vendin tim.

Çfarë përfaqëson Pogradeci për ju sot?

Pogradeci është dashuri, por ama Pogradeci i fëmijërisë sime! Ky i sotmi është një konglomerat ngjyrash të pazakonta që nuk kanë të bëjmë fare me Pogradecin tim! Kur shkoj, shijoj pafundësinë e ujit të liqenit tim, dritën e mirësinë e asaj mase të pafund që ta bën shpirtin poezi dhe të mirë.





Linda Shala

GRUAJA QË S'DI TË NDALET

Në punën tuaj si producente ekzekutive në televizionin e Prishtinës, cilën kujtoni si sfidën më të madhe?

Sfida e madhe ishte aplikimi i krejt asaj që kam mësuar e si jam edukuar gjër atëherë, pa i lejuar rrethanat që të më deformojnë profesionalizmin dhe vizionin. Vendosja e profesionalizmit si diçka ultimative në vendin e pasluftës, ku kishte rrezik që disa merita të tjera ta mbizotërojnë aftësinë dhe diturinë. Pastaj, vinte zgjedhja e stafit në një shtet ku për shumë vite nuk kishte patur shkollim të denjë. Pasonte edhe vendosja e barazisë gjinore, jo lehtë e kapshme për mentalitetin kosovar, sidomos kur femra vendos e jep urdhra. Kisha detyrë ta informoja drejt një popull në një moment shumë optimist edhe ta argëtoja fort pas një periudhe të gjatë të vuajtjes; të fus në një televizion tradicional e konservativ dozën e duhur të komercialitetit, duke mos bastarduar qëllimet e televizionit publik. Dhe, në fund, kisha detyrim t'i implementoj të gjitha metodat e reja që stafi i huaj i solli në Kosovë, e njëkohësisht t'ia bëj me dije që ne nuk jemi të paditur, që nuk jemi pa traditë, që nuk jemi pa rrënjë e pa modernizëm.

Gazetaria dukej se do të ishte profesioni juaj, çfarë ndodhi që e ndryshuat kah? Iu drejtuaat biznesit?

Gjithë jetën kam qenë e rrethuar me tema ekonomike, nga babai, një ndër ekonomistët më të shquar të kohës, si studente në Fakultetin Ekonomik, si pionere në biznes privat, me kolegët në biznes nëpër shumë takime, mbledhje, fushata, programe... Por, nuk mund t'i ikë përshtypjes që gjithë kohën kam ikur në një pjesë shumë të rëndësishme të qenies sime – gazetare menaxhere Puna në TV, në revista, puna në modë me shtëpinë "Linea Bianca", puna në Talk Show, pastaj angazhimi në organizimin e festivaleve "Show Fest" e "Video Fest", gjithashtu duke kontribuar në programet artistike të RTP-së dhe RTK-së... Pastaj edhe gjithë dashuria ime ndaj sportit, basketbollit në veçanti... Shumë e vështirë t'ia gjej vetes një emërtim të vetëm. Një gjë e di sigurt, që sot edhe arti më i madh, vështirë ekziston pa ekonomi e biznes, kështu që e marr pasuri të madhe atë dituri ekonomike që ma ka lënë familja dhe ma ka mësuar përvoja në biznes. Kjo dituri më ka mundësuar që më lehtë e pa stres material ta shpreh

anën time kreative jo vetëm në biznes, e që mua më ka plotësuar shumë. Do ta veçoja emërtimin QËNDRUSHMËRIA si nocion ekonomik, po edhe si virtyt njerëzor.

Tenxheret e tamlit, çfarë ndjesie ju përcillte tek sa ju i shisnit apo gjendeshit përpara një produkti fizik si tenxherja, ndërsa ishit mësuar me produktin mediatik?

Do të ndërlihem me pyetjen paraprake. Kur njeriu ka në vete shpirt krijues, ai atëherë do të shprehë kreativitetin edhe në shitjen e tenxhereve të tamlit. Nëse do dhe di, mund të bëhesh edhe artist i shitjes, edhe dizenjator i vitrinës, edhe kreator i një koncepti, edhe artist i komunikimit me njerëz... Fillimet e ndërmarrësisë ishin thujtë traumatike, kur një të reje që kishte pasion gazetarinë i imponohet mbijetesa dhe shitja e tenxhereve të tamlit është e dhimbshme, por unë edhe ato i kam shitur me pasion dhe jam mundur që të jem sa më kreative

në shitjen e tyre. Bukurinë e jetës mund ta gjeni kudo nëse bëheni artist i jetës suaj.

Arsyeja e futjes në biznes ishte mbyllja e televizionit ku punonit apo kushtet në të cilat u gjendët ju dhe familja juaj?

Arsyeja e parë ishte mbyllja e dhunshme e Televizionit të Prishtinës ku unë punoja si gazetare. Situata e atëhershme në Kosovë na solli familjen në një gjendje të vështirë ekonomike, ishte në pyetje mbijetesa. Por, sot kur e mendoj, futja ime në biznes do të bëhej gjithsesi por pak më vonë, jo dhunshëm, por natyrshëm. Biznesi im i parë ishte një dyqan i produkteve të kozmetikës që e nisëm me vëllain tim. E quajtëm kozmetika "Linda", aty unë gjeta hapësirën që të shpreh kreativitetin tim dhe të mësoj të gjitha rregullat por edhe deformimet e tregut. Të mësoj kontabilitetin, marketingun, komunikimin me klientët..., hyra në një botë tjetër që nuk e kisha menduar më parë, pak e trembur por me vendosmërinë që do t'ia dal. Nga dyqani i vogël i kozmetikës me kalimin e viteve arrita që të menaxhoj kompaninë time me afro 100 të punësuar. Mbi 30 vite në biznese të ndryshme kam kuptuar se fuqizimi ekonomik i individit, i gruas po edhe i shoqërisë është instrumenti më i fuqishëm që emancipon dhe që krijon parakushte për zhvillimin e shoqërisë dhe mirëqenien e tyre në të gjitha aspektet.

Sa personalitetit e ke marrë në studio duke iu shkuar në shtëpi?

Ky është rasti me kryeministrin e sotëm të Kosovës z. Albin Kurtin. Ai kishte dalë nga burgu në Serbi dhe kishte arritur në Prishtinë në banesën e tij. Unë në atë kohë isha producente ekzekutive në Radio Televizionin e Kosovës dhe e kuptoja nevojën që ai t'i adresoj opinionit. Dhe normalisht në asnjë moment nuk hezitova, shkova dhe e mora në banesën e tij për në studion televizive. Profesionalizmi, korrektësia dhe aftësitë komunikuese t'i hapin të gjitha dyert. Ishte ky një rast i veçantë, në përgjithësi kam gëzuar një respekt si gazetare, por edhe si ndërmarrëse dhe korrektësi në trajtim nga personalitetet në shoqërinë tonë. **Gruaja e fuqishme apo e suksesshme shqiptare për ju?**

Detyrimet e gruas shqiptare sot janë tejet të komplikuar. Të jetë sa shqiptare po aq kosmopolitane, të jetë sa moderne aq tradicionale, të jetë sa punëtore aq edhe egoiste për energjinë e vet, t'i përmbushë kërkesat që ia ka dhënë shoqëria, por mos të lejojë që ajo shoqëri ta eksploatojë, të jetë bashkëshorte e nënë e përkushtuar, por jo rob i familjes... Ka qindra e mijëra baraspesha që duhet t'i perfeksionojë gjatë jetës... E, këto baraspesha nuk ia kanë mësuar gjeneratës sime, përkundrazi, na kanë mësuar: jep sa më shumë, dëshmohu sa më shumë, ji në shërbim, se sa shërben - aq vlen. Kur shërben shumë mund ta humbasësh fuqinë, mund të quhesh shërbëtorë e jo grua e fuqishme. Në anën tjetër, pa qenë në shërbim të dikujt apo diçkaje, ju humbisni esencën tuaj e të qenit njeri. Pra, gruaja që ka arritur ta gjejë këtë baraspeshë, e me të edhe paqen e saj - mund të quhet grua e suksesshme shqiptare. Fatmirësisht unë njoh shumë të tilla.



#NGA BRUNILDA GOROVELLI

Linda Shala është një grua që ka jetuar dhe ndër-tuar rrugëtimin e saj paralelisht me historinë e Kosovës. Nga gazetaria dhe televizioni, te sipërmarrja dhe menaxhimi, ajo ka ditur të qëndrojë e fortë në kohë sfidash, duke e kthyer çdo rrethanë në mundësi. Në këtë intervistë vjen me një rrëfim për qëndrueshmërinë, guximin dhe artin e të jetuarit me pasion.

Linda si veprimtare keni lënë gjurmë të rëndësishme në historinë dhe jetën sociale e ekonomike të Kosovës. Cili është momenti kyç në rrugëtimin tuaj?

Jam grua shqiptare e lindur në Ballkan, kam jetuar mes dy shekujve e mes dy mileniumeve. Së pari në një sistem socialist e komunist, pastaj nën qeverisjen e UNMIK-ut e EULEX-it, për të përjetuar edhe shpalljen dhe ndërtimin e shtetësisë së Kosovës. Kam jetuar gjithmonë në të njëjtin vend, por ai vend ka ndryshuar shumë emra e shumë valuta. Jam shkolluar, martuar, kam lindur e rritur fëmijën në rrethana shumë specifike, përjetuar luftë, të qenurit refugjat, tranzicionin e pasluftës, kam punuar në institucion edhe në biznesin privat, kam patur poste por, kam funksionuar edhe si tregtare, këshilltare, aktiviste e shoqërisë civile, bijë, bashkëshorte dhe nënë. Nga fleta e bardhë dhe lapsi kam kaluar në bisedë me Al... Jam lindur si gjenerata X, jam edukuar nga Silent Generation, kam edukuar Millennials, sot rrugëtoj me Alpha gjeneratën... E kam shumë të vështirë ta them cili moment ka qenë momenti kyç i jetës sime. Më kanë përkufizuar shumë momente nga rrugëtimi im jetësor me shumë sfida dhe momente të bukura. Por e them me plot gojë, jeta është e bukur.



Linda fëmijë, fotot e tua, kujtimet janë të lidhura më shumë me Mitrovicën apo Prishtinën?

Unë kam jetuar në Prishtinë, por me Mitrovicën me lidh origjina e prindërve të mi dhe kohët e bukura të pushimeve shkollore që i kam kaluar te gjyshërit në Mitrovicë. Lidhja me Mitrovicën, qytetin e Minatorëve, është forcuar edhe me faktin se babi im Aiz Abrshi ka qenë drejtor i Kombinatit Trepça në Mitrovicë, gjatë kohës së grevës së Minatorëve të vitit 1989, u burgos bashkë me ta dhe qëndroi 14 muaj në burgun e Mitrovicës. Kjo pjesë e historisë sonë në përpjekjen për pavarësi të Kosovës u bë pjesë e jetës sonë dhe lidhjes së afërt me minatorët e Trepçës dhe qytetin e Mitrovicës. Dhe sigurisht natyrshëm në vitin 2003, unë marr përsipër menaxhimin e Klubit të Basketbollit Trepça të Mitrovicës, si gruaja e parë në Kosovë e angazhuar

në udhëheqjen e një klubi të meshkujve. Megjithatë, Prishtina është qyteti im ku jam rritur, kam kryer shkollimin, fakultetin, ku kam shtëpinë time, familjen time, miqtë e mi më të dashur, jetën time. Sa herë kthehem nga ndonjë udhëtim, ndjej gëzim kur shoh Prishtinën time.

Me cilin nga familjarët keni raporte të ngushta?

Unë kam një vëlla. Gazmend Abrashin, është një vit më i vogël se unë, jemi rritur dhe zhvilluar së bashku falë afërsisë në moshë. E kemi filluar së bashku rrugëtimin tonë në biznes, është një punëtor i madh dhe shumë i suksesshëm. Kemi një lidhje të veçantë, që e kemi kultivuar ndër vite me kujdes dhe dashuri. Është shumë i rëndësishëm në jetën time dhe falë raportit tonë të ngushtë, sfidat e jetës i kemi përballuar më lehtë së bashku. E kam thënë që vëllain tim Menen si e quaj unë, e kam dhuratën më të bukur nga prindërit.

Djali, mrekullia juaj, Roberti... si ndjeheni si nënë e tij?

Roberti tashmë mbush 32 vite, është ekspert i sigurisë kibernetike dhe AI iniciativave të sigurisë. Ka përfunduar studimet master në Georgetown University në Washington. Është një ndërmarrës i suksesshëm në këtë lëmi dhe së fundi ka filluar të ligjërojë në Rochester University of Technology në Prishtinë. Rrugëtimi i tij ishte shumë interesant për ne si prindër dhe familje, sepse zgjodhi një fushë për të cilën ne në fillim nuk kishim edhe shumë njohuri. Ishte zgjedhja e tij që ne e mbështetëm. Ajo që mendoj që e ka mësuar e trashëguar nga familja është kultura e punës dhe përkushtimi në punë. Është i kujdesshëm për familjen, shoqërinë dhe sigurisht është biri im, mrekullia ime i cili më bën krenarë. Roberti është martuar, tashmë familja jonë është plotësuar edhe me Andrrën. Unë dhe bashkëshorti im e kemi pranuar si vajzën tonë që nuk e patëm. Është një vajzë fantastike që e duam shumë.

Për të gjithë ata që ende nuk e dinë si jeni njohur ju dhe bashkëshorti juaj?

Unë dhe Alberti jemi bashkë 42 vite, sivjet kremtojmë 35-vjetorin e martesës. Jemi njoftuar në Mitrovicë në një mbrëmje argëtuese dhe shumë shpejt të dashuruar, e kemi kuptuar se jemi për njëri-tjetrin. Sekretin ynë mendoj se qëndron në faktin që e kemi pranuar njëri-tjetrin ashtu si jemi, pa tendencë që ta ndryshojmë njëri-tjetrin. Albertin e kam pas përkrahës të fuqishëm në gjithë rrugëtimin tim. Më ka mbështetur në të gjitha aspektet, ka pasur respekt për angazhimet e mia dhe është munduar dhe vazhdon të më lehtësojë obligimet aty ku ka hapësirë. Është shumë e vlefshme kur partnerin e ke edhe shok, edhe bashkudhëtar besnik në kohëra të mira, por edhe në ato të vështira. E konsideroj veten me fat në këtë aspekt.

Çfarë e mban një martesë të fortë dhe të qëndrueshme me kalimin e viteve?

Cjeneratën time e kanë mësuar që në martesë hyhet nga dashuria. Mbase ishim gjeneratë e ledhatuar në këtë aspekt! Edhe shumë para nesh, e edhe në shumicën e rasteve sot, llogaritjet martesore janë bërë thujtë të zakonshme. Fatkeqësisht, këto llogaritje kohët e fundit nuk po dalin të sakta. Martesa si institucion është në krizë, e me të edhe lumturia bashkëshortore. Ndoshta është gabimi pse martesa identifikohet qoftë me dashurinë, qoftë me interesin. Martesa duhet të identifikohet me martesën! Martohuni vetëm dhe vetëm nëse e doni jetën bashkëshortore, e cila paraqet mijëra cikërrime e detyrime që zgjasin ditë, vjet, dekada... dhe që kërkon përkushtim dhe dedikim. Kur doni këtë jetë, kur doni me të vërtetë të ndani me dikë çdo gjë në jetë, ju gjeni mënyrën që të funksiononi dhe sakrifikoni për atë bashkësi.

PIPERO DENTAL STUDIO

SHËRBIMET QË DO TË GJENI:

- Terapi
- Kirurgji dhe implantologji
- Ortodonci
- Periodontologji
- Pedodonti
- Mesoterapi
- Dermapen 4
- Zbardhim me lazer



DHE RISIA E FUNDIT E LAZERIT ALFA FORMATK” PËR EPILIMIN DEFINITIV SKIN REJUVENATION DHE LARGIMIN E NJOLLAVE

DOKTORESHË ERISELDA PIPERO

E SPECIALIZUAR NË KIRURGJI DHE IMPLANTOLOGJI



Renisa Lacka

ANDRÉ, KRYEVEPRA E ROLEVE TË MIA

#NGA OLSI KOLAMI

#FOTOGRAFIA: ANDIS RADO

Kur imagjimon jetën e një sopranoje të vjen në mend Maria Callas, një diva dhe kaq! Por, kur takon Renisa Lackën kupton se përtej rolit skenik të artistes, ajo nuk është vetëm Violeta Valery e “La Traviata”, por një grua, bashkëshorte, e së fundmi mamaja e lumtur e André. Edhe pse ka gdhendur shumë karaktere nga kryeveprat operistike, ajo nuk do ta kishte imagjinuar që ardhja në jetë e të voglit të saj do të transformonte krejt jetën e saj. Krijimi i një kryevepre si André do të zbulonte tek ajo ngjyra të reja në dimensionin artistik, por jo vetëm. Në këtë intervistë për “Bordo”, artistja e rrëfen jetën nën efektin magjik të operës, nga shkollimi në Athinë te besimi që ajo ka te muzika klasike si domosdoshmëri shpirtërore, e padyshim disa risi që kanë mbushur me emocione të reja jetën e saj.

Soprano dhe mama me kohë të plotë, si po e ndan Renisa këtë kohë?

Rikthimi im në Opera pas lindjes erdhi shumë shpejt, por në mënyrën më të natyrshme dhe emocionale të mundshme. Për mua ishte një nevojë shpirtërore, një mënyrë për të ruajtur identitetin tim artistik, ndërkohë që përqafoja rolin më të bukur, atë të mëmësisë. U riktheva në muajin e katërt pas lindjes me një ndjesi kureshtjeje: si do ta gjeja zërin tim? Thellësinë e tij? Ngjyrat e reja?

Sepse lindja, në rastin e një sopranoje lirike sjell një pjekuri shumë të madhe në kordat vokale. Mendoj se gjithçka vjen për mirë dhe me fuzion nga momenti që bëhesh nënë, ku fatmirësisht ne sopranot e kemi fatin ta përjetojmë. Sot koha ime ndahet mes bebit André dhe Operës.

A i keni kënduar ndonjë arie speciale bebit gjatë shtatzënisë?

Gjatë gjithë shtatzënisë kam qenë aktive profesionalisht. Madje kam bërë prova deri në javën e 41-të, një periudhë shumë e veçantë, sepse bebi dukej sikur ishte rehatuar aty (qesh). Në muajt e fundit i këndoja shpesh një romancë ruse: “Zdes khorosho” – “Bukur është këtu”. Ishte një reflektim i gjendjes sime të brendshme. Gjatë asaj kohe, në botën time ishte realisht bukur. Dhe ndoshta ai e ndjente këtë.

Çfarë ka ndryshuar në raportin tuaj me artin pasi u bëtë nënë?

Mëmësia i riorganizon prioritetet në mënyrë shumë natyrale. Një fëmijë vendos gjithçka në perspektivë. Nëse më parë ndihesha sikur nuk jetoja dot pa artin, sot e ndiej që arti im jeton më bukur kur jam e plotësuar si grua dhe si nënë. Arti më ndihmon të ruaj balancën. Kur i këndoje André dhe shoh se si qetësohet, e kuptoj se profesioni im nuk është vetëm karrierë, por një dhuratë që më shërben edhe në jetën personale.

Ju i takoni brezit të ri të sopranojeve, si e shihni skenën operistike sot?

Të jesh soprano sot është sfiduese. Ka shumë konkurrencë, krahasime dhe pritshmëri të larta. Por në fund, puna e vazhdueshme dhe besimi në vete mbeten themeli. Skena operistike sot ofron shumë mundësi, por edhe ritëm të shpejtë. Ndoshta ajo që mungon ndonjëherë është vlerësimi i thellë dhe i qëndrueshëm për artin operistik, si në kohën e Callas apo Pavarotti. Megjithatë, unë besoj se muzika klasike mbetet një domosdoshmëri shpirtërore, sidomos për brezin e ri.

Pas studimit në Athinë dhe eksperiencave të tjera, si ka qenë rikthimi në Shqipëri?

Rikthimi në Shqipëri ka qenë një ftesë dhe sfidë për mua! Mu ofrua një mundësi për të shkelur skenën operistike shqiptare. E pranova me kënaqësi, duke dhënë akoma edhe kësaj dite shpirtin për teatrin tim. Dhe për këtë do të jem përherë mirënjohëse dhe falënderuese, pasi e njoh në lëkurë si është të vlesh edhe fati të të mungojë. Teatri i Operës dhe Baletit është tempulli ku unë falem çdo ditë. Shqipëria pastaj si vend ma ka bërë rikthimin më të lehtë pasi gjithmonë më pëlqente ideja që të bëhesha dikush dhe të lija dhe unë një gur në vendin tim si shumë e shumë emra të tjerë.

Cili rol ju ka sfiduar më shumë emocionalisht, por edhe teknikisht?

Violetta Valery nga opera “La Traviata” e Xhuzepe Verdit ka qenë roli më sfidues mendoj, ndoshta sepse ka qenë roli i parë me të cilin kam hyrë në teatër. Akoma e kësaj dite kujtoj ato emocione dhe ndiej në trup mornicat që përjetova kur sipari i shfaqjes u myll. Ka qenë një natë që nuk do ta harroj kurrë. Është intere-



Violetta VALERY nga opera “La Traviata” e XHUZEPE VERDIT ka qenë roli më SFIDUES mendoj, ndoshta sepse ka qenë roli I PARË me të cilin kam hyrë në teatër. Akoma E KËSAJ dite kujtoj ato emocione dhe ndjej në TRUP mornicat që PËRJETOVA kur sipari i shfaqjes u mbyll.



sante se si duartrokijtjet e publikut në fund të përshëndetjes mund të të pushtojnë të gjithën. Është një nga rolet më të vështira të repertorit operistik, si emocionalisht ashtu edhe teknikisht. Violetta është një rol që kërkon një elasticitet shumë të mirë të kordave vokale, pasi ti duhet t'i përshtatesh asaj tre lloje zërash. Në akt të parë atë koloraturë, në të dytin atë lirike dhe në të tretin dramatikën. Por kjo është edhe e bukura e së gjithës, që të veshësh personazhin në çdo detaj të tij të mundshëm. Përfshirja emocionale që duhet të përjetosh për t'i dhënë jetë këtij personazhi që venitet pak nga pak është edhe sfida më e madhe për çdo soprano që këndon këtë rol.

A ka një moment në skenë që do ta konsideronit “magjik”?

Skena në vetvete është magjike. Çdo herë që ngrihet sipari, ndodh diçka e papërsëritshme...!

Një grua artiste, a sakrifikon më shumë se një burrë në këtë profesion?

Mendoj se realitetet janë të ndryshme. Një grua artiste që është nënë dhe bashkëshorte shpesh menaxhon më shumë role paralelisht. Kjo kërkon organizim, disiplinë dhe shumë forcë të brendshme. Por nuk do ta quaja vetëm sakrificë, është edhe një burim fuqie. Artistët meshkuj shpesh kanë më shumë hapësirë për fokus të pastër artistik, ndërsa ne si gra mësojmë të performojmë në disa skena njëkohësisht në shtëpi dhe në teatër. Në fund të ditës, sukcesi nuk matet me krahasim, por me integritetin dhe përmbushjen personale. Dhe kur një artiste arrin të jetë e realizuar si profesioniste dhe si grua, kjo është forma më e lartë e elegancës.



ITALOPTIK

ITALOPTIK, PËRTEJ BIZNESIT SHTRON IFTAR PËR KLIENTËT!

Të qenët prej 30 vitesh në tregun e optikës, nuk është vetëm një numër që mat vitet dhe dëshmon fillimin e optikave private në vend, por nga ana tjetër dëshmon edhe suksesin në marrëdhëniet njerëzore, që ky biznes ka krijuar mes vitesh me klientët e vet besnikë. Për këtë arsye në vigjilje të muajit të Ramazanit, drejtuesja e ItalOptik Romina Lula, shtroi një iftar për klientët e saj besnikë myslimanë, që mbajnë agjërim. Një ide kjo, që më shumë se inovatore tregon ndjeshmërinë, që ka Lula përballë blerësve, që zgjedhin syze optike dhe dielli, por edhe marrëdhënien që ajo ka krijuar ndër vite me ta. Në fakt kjo nuk është hera e parë, që ItalOptik ndërmerr iniciativa të tilla. Paralel me këtë event gjatë gjithë muajit të Ramazanit, gjithë vizitat okulistike janë falas për besimtarët myslimanë, e ndërkohë që aplikohet edhe një ulje për blerjet. Sipërmarrjet e ItalOptik në fushën e bamirësisë janë të shumëllojshme dhe të vazhdueshme, duke treguar një solidaritet, që duhet ta ketë çdo biznes edhe për njerëzit më vulnerabël dhe të pamundur fizikisht apo financiarisht. Një shembull ky që duhet të frymëzojë jo vetëm individët, por më së shumti edhe bizneset.

Çiljeta Xhilaga

NËNË PA ETIKETA!

#NGA BRUNILDA GOROVELLI

#FOTOGRAFIA: ANDIS RADO

Ekujt do t'ia merrte mendja që do të vinte një ditë kur një gazetare do të zhvillonte një bisedë me Çiljeta Xhilagën për prioritetet e saj si nënë, bashkëshorte dhe grua. Në fakt, ky është një tjetër sukses i këngëtares, të cilin sikurse ajo e thotë në këtë intervistë për "Bordo", e ka realizuar përpara syve tanë, si një libër i hapur, ashtu siç ka bërë dhe me sukseset në muzikë. Kur them kujt do t'ia merrte mendja, i referohem asaj që për të quhet fokus i suksesit, një jetë plot me angazhime familjare, koha e së cilës është e ndarë te tre meshkujt e familjes së saj, saqë ndonjëherë është e vështirë që të gjejë kohën për të realizuar një intervistë si kjo e këtij muaji, pa dorëza e plot të vërteta. Megjithatë, e vetmja gjë që nuk ka ndryshuar te Çiljeta është humori dhe buzëqeshja e saj. Ashtu me dashurinë për jetën, dëshirën për të pasur dhe një tjetër fëmijë, Çiljeta vjen në studion fotografike për të përcjellë te gratë lexuese një tjetër profil suksesi të gruas shqiptare. **Çiljeta nga vajza publike në gruan dhe nënën e shtëpisë, si është për ju ky shndërrim?**

Nuk ka qenë një ndryshim identiteti, por një zgjerim i tij. Vajza publike ishte drita, energjia, entuziazmi i një moshe që kërkon të pushtojë botën. Gruaja dhe nëna janë thellësia që vjen pasi kupton se bota nuk pushtohet – ndërtohet. Nga dëshira për të qenë e admiruar, kalova te nevoja për të qenë e qëndrueshme. Nga duartrokitjet te përgjegjësia. Sot nuk mat veten me famë, por me ndikim. Dhe ndikimi më i madh nuk është ai që lë në publik, por ai që lë në shtëpi. **3 djem, si është atmosfera në shtëpinë tënde kur gjendeni përpara një ndeshje futbolli?**

Është kaos i bukur. Është zë, emocion, tension. Por përtej lojës, unë shoh mësimet. Shikoj si përballen me humbjen. Si reagojnë ndaj padrejtësisë. Si menaxhojnë krenarinë kur fitojnë. Futbolli është vetëm pretekst – karakteri formohet aty. Në ato momente, unë jam më shumë se mami që

brohoret. Jam grua që kupton se po rrit burra. Dhe më e rëndësishmja për mua është që ata të mësojnë dinjitetin, jo vetëm rezultat.

Deri më tani publiku ka njohur vetëm "gjysmën" e Çiljetës?

Publiku njeh atë që është ekspozuar. Dhe çdo figurë publike, në njëfarë mënyre, është një narrativë e përzgjedhur. Por, njeriu është shumë më kompleks sesa imazhi i tij. Gjysma tjetër e imja është ajo që hesht, që mendon, që dyshon, që fal. Ajo që lexon, që rritet, që e pyet veten çdo ditë nëse po bën mjaftueshëm si nënë dhe si grua. Nuk jam vetëm ajo që është parë. Jam edhe ajo që është përpunuar në heshtje. **Ka një version të Çiljetës që e njohin vetëm djemtë e shtëpisë?**

Po. Ata njohin versionin tim më të pambrojtur dhe më të fortë njëkohësisht. Më shohin kur jam e lodhur, kur jam e shqetësuar, kur jam duke reflektuar. Dhe njohin dashurinë time jo si deklaratë, por si sakrificë të përditshme. Ky është versioni që nuk ka nevojë për publik. Sepse është i plotë në vetvete.

Çfarë ke mësuar për veten pasi u bërë nënë?

Kam mësuar që forca nuk është zhurmë. Forca është qëndrueshmëri. Kam mësuar që dashuria e vërtetë nuk është emocion, është përgjegjësi. Kam mësuar që egoja bie, kur përballësh me një qenie që varet plotësisht nga ti. Mëmësia më zhveshi nga iluzionet dhe më përballi me thelbin tim. Dhe në atë proces, u rrita.

Çfarë do të doje të mos trashëgonte nga ty djali yt?

Impulsivitetin. Sepse kam kuptuar që reagimi i shpejtë nuk është gjithmonë forcë. Dhe ndjeshmërinë e tepruar. Sepse zemra e butë është bekim, por duhet të shoqërohet me mendje të kthjellët.

Nëse mëmësia do të ishte një fjali për ty?

Mëmësia është procesi ku një grua mëson të jetojë jo për veten... por për diçka më të madhe se vetja.





Çfarë do të thotë për ty të jesh nënë e fëmijës tënd dhe Albanit?

Do të thotë të mbash një familje jo vetëm me dashuri, por me ekuilibër. Të jesh qendra që mban bashkë dy energji të forta. Është përgjegjshmëri dhe dhembshuri dhe një dashuri që më përmbush çdo ditë.

A ka ditë kur ke dashur të jesh thjesht grua, jo nënë, jo bashkëshorte?

Po. Sepse edhe gruaja ka nevojë për hapësirë. Por më pas kuptoj që të gjitha këto role janë pjesë e së njëjtës qenie. Dhe unë jam në paqe me to.

A ndihesh ndonjëherë fajtores që zgjodhe veten përpara karrierës?

Jo. Sepse zgjedhja për të qenë e pranishme në jetën e fëmijëve të mi nuk është heqje dorë nga ambicia – është ripërcaktim i saj. Suksesi nuk është vetëm profesional. Suksesi është të rrisësh njerëz të mirë. Dhe kjo është forma më e lartë e arritjes.

Dashuria ndahet apo shumëzohet kur një grua bëhet nënë e dy fëmijëve në mënyra të ndryshme?

Dashuria shumëzohet. Ajo merr forma të ndryshme, por nuk zvogëlohet kurrë. Zemra e një nëne ka kapacitet që nuk matet me logjikë.

Nëse sot do të dilje me një këngë, a do të ishte për publikun apo për veten?

Do të ishte për veten. Sepse arti i vërtetë lind nga nevoja për të shprehur të vërtetën tënde. Nëse publiku e përqafton, është dhuratë. Por nuk do të ishte më provë për askënd. Do të ishte dëshmi e një faze të re, më të qetë, më të pjekur.

Çfarë ke frikë të humbasësh më shumë? Qetësinë e brendshme. Sepse pa qetësi, edhe suksesi bëhet i zbrazët.

Kur fiket kamera, për çfarë mendon më shpesh?

Mendoj që të iki në shtëpi me vrap, që të organizoj gjërat (qesh).

A ka pasur momente që je pënduar që u bërë figurë publike shumë herët?

Jo pëndim. Por ka pasur momente lodhjeje. Sepse kur rritesh në publik, nuk ke të drejtë të jesh e papjekur.

Cili ka qenë kompromisi më i madh që ke bërë për famën?

Të rritem para syve të të gjithëve. Të bëj gabime publike. Dhe të mos kem luksin e heshtjes.

BOUNDO

MEN

estetikë

Kremrat
më të mirë

PËR BURRA

Superdizajneri

MARC


JACOBS

trend

Pranverë/Verë

'26

Trend,
stil
autentik



SARDI
Strugoj

NË KËRKIM TË AUTENTICITETIT



Oppo
Reno 15

Marka Oppo hedh në treg serinë Reno 15, një linjë e re telefonash me dizajn elegant, kamera 50MP që ofron opsione portretesh dhe sensorë ultra të gjerë për foto ballore dhe lente telefoto. Telefoni vjen i ndryshuar edhe falë baterisë që zgjat dhe ka karikim të shpejtë, ndërsa sistemi ColorOS 16 integron inteligjencën artificiale, duke e kthyer ekranin AMOLED në një eksperiencë unike me pamje dinamike që duken si të gjalla.



Huawei Watch
Ultimate 2

Jepini vlerë kohës suaj, Huawei, seria Watch Ultimate 2. Ora është një kombinim i inxhinierisë dhe dizajnit, dallon për pamjen sportive dhe për faktin që është rezistente në ujë deri në 150 metra thellësi. Siguron matjen e parametrave të mirëqenies, si: monitorimi i gjumit, rrahjet e zemrës dhe treguesit emocionalë. Falë eSIM-it, ju mund t'u përgjigjeni thirrjeve pa telefon, ndërsa mikrofoni izolon zërin tuaj dhe zvogëlon zhurmën e ambientit.



Maska **Foreo**

Nëse ju pëlqen teknologjia e re e maskave LED, modeli ideal është FAQ 202 Wireless nga Foreo. Me një dizajn elegant, pajisja kushton 1000 euro dhe nuk është thjesht një produkt estetik, pasi falë dritës së kuqe ndihmon në rigjallërimin e lëkurës në mënyrë magjike. Kjo maskë përdor tetë gjatësi valësh të ndryshme të cilat ndihmojnë në rritjen e kolagenit, zbutjen e rrudhave dhe zvogëlimin e akneve.




Pitbull
Platinum
PRO

I projektuar për ruajtjen e mjekrës së një burri modern, Pitbull Platinum PRO ka një shtresë tehes të mprehtë, të cilat realizojnë prerjen e qimeve në thellësi, duke ndjekur format e lakuara të fytyrës, pa e acaruar lëkurën. Format i vogël e bën të përshtatshëm për t'u marrë ngado me vete nëpër udhëtime, ndërkaq falë opsionit rezistent ndaj ujit, mund të përdoret edhe në dush. Merreni kur jeni në lëvizje, pasi mban disa orë karikimi.



Volvo
EX60

Modeli EX60 nga gjiganti Volvo vjen me versionin elektrik. Ka dizajn thellësisht nordik, një kabinë minimaliste me ekran peizazhistik dhe Google Gemini AI. Automobili është ndërtuar sipas platformës SPA3 që integron baterinë qelizë në karroceri, ka autonomi 810 kilometra dhe mund të karikohet nga 10 në 80 për qind në 18 minuta. Elektrik dhe pa gjeste epike, EX60 dallon për shpejtësinë, arrin 0-100 km/orë në 3,9 sekonda.



Anua 70+
HEARTLEAF 70 + CERAMIDE
ANUA HEARTLEAF 70 INTENSE CALMING CREAM
ANUA HEARTLEAF 70 CRÈME APAISANTE INTENSE
50 ML / 1.69 FL. OZ.



Kremrat
më të mirë
për burra



Zgjedhja e kremrit të duhur të fytyrës për burrat është gjithçka. Lëkura ka nevojë dhe jep rezultate vetëm nëse keni zgjedhur kremrin e duhur. Ndaj, rezultatet vijnë vetëm kur kremi i përgjigjet një nevojë reale dhe jo një pritshmërie abstrakte. Hidratimi, ushqyerja dhe mbrojtja nuk janë vetëm fjalë për një etiketë, por funksione konkrete që duhet të pasqyrohen në lëkurë. Ne kemi zgjedhur kremrat më të mirë për meshkuj që trajtojnë lëkurat e thata në pak kohë, por edhe ato që funksionojnë duke luftuar rrudhat dhe duke respektuar ekuilibrin. Por, magia nuk ndodh brenda natës, ndaj duhet t'i përdorni ato vetëm një herë, thjesht t'i bëni pjesë të rutinës suaj estetike. Nuk ka nevojë ta shndërroni çdo blerje në një seancë analize kozmetike; thjesht duhet të ndaloni së kërkuari zgjidhje mrekullibërëse. Gabimi i parë është të besosh se ekziston një formulë universale që funksionon në çdo fazë të jetës. Lëkura ndryshon vazhdimisht me kalimin e kohës, stinët, stilin e jetës, stresin dhe cilësinë e gjumit. Një krem që funksionoi perfekt një vit më parë, mund të jetë i pamjaftueshëm. Zgjedhja e duhur gjithmonë fillon me vëzhgimin e përditshëm. Si reagon lëkura pas pastrimit, efektet gjatë gjithë ditës, si dhe çfarë ndodh gjatë natës. A është e tendosur dhe a ka shkëlqim? Çdo reagim është informacion i vlefshëm. Ndaj niseni me një krem që flet gjuhën e lëkurës suaj dhe sapo të shihni rezultatet do të kuptoni se ai është i duhuri.



Sardi Strugaj

në kërkim të autenticitetit

📍 NGA BRUNILDA GOROVELLI

📷 FOTOGRAFIA: RENUAR LOCAJ

Pas zërit të njohur dhe projekteve të suksesshme që publiku sheh në skenë, fshihet një rrugëtim i mbushur me punë, sakrificë dhe dilema personale. Sardi Strugaj flet hapur për prapaskenat e karrierës së tij, koston reale të suksesit, presionin e famës dhe nevojën për të mbetur autentik në një industri që ndryshon vazhdimisht. Në këtë intervistë, ai rrëfen anën njerëzore të artistit, frikërat, kompromiset dhe pasionin që e mban ende të lidhur fort me muzikën.

Çfarë nuk shihet pas skenës së një këngëtarit të suksesshëm?

Në prapaskenat e mia ka gjithmonë një grup njerëzish që merren me shumë detaje, që nga gjërat më të vogla, deri tek ato më të mëdha, të gjitha shumë të rëndësishme. Përtej të qenit këngëtar apo autor këngësh, pjesa më e rëndësishme është pjesa e transmetimit të këngëve te dëgjuesit. Jam njeri me fat dhe rrethohem me njerëz profesionistë që kujdesen për mbarëvajtjen e projekteve të mia.

A të ka ndryshuar fama si njeri?

Pak po. Nuk ka se si mos të të ndryshojë. Një njeri publik duhet të ketë vetëpërmbytje para shumë situatave, që një njeri jo publik ndonjëherë e lëshon veten. Duhet të jesh i qeshur, edhe atëherë kur mbase nuk të vjen të qeshësh.

Cilat janë shpenzimet për një artist që publiku nuk i imagjino?

Industria në Shqipëri është rritur dhe përmirësuar shumë. Që do të thotë se pritshmëria e publikut ndaj artistëve që ndjekin është e madhe. Një këngë e bukur, ka kosto për t'u krijuar. Ashtu dhe një video do një grup artistësh në krijimtari dhe realizim. Pjesa më e rëndësishme pas këngës, që shpeshherë publiku nuk e di, është marketingu. Gjithashtu, dhe pjesa me koston më të larta. Imazhi kërkon dedikim dhe të gjitha këto, që të dalë një produkt i mirë, mund të fillojnë nga 7000 € deri në 10.000 €.



A është më e shtrenjtë fama apo sukcesi?

Mendoj që sukcesi është më i shtrenjtë, në të gjitha kuptimet e fjalës. Fama sot është pak më e thjeshtë për shkak të mundësive që të japin shumë platforma, si rrjetet sociale apo edhe programet televizive. Sukcesi kërkon shumë mundim, vullnet dhe disiplinë.

Kush je ti kur nuk je artist?

Me thënë të drejtën nuk ndryshoj shumë, por përtej pjesës publike, imazhit që kam si njeri i qetë, kam edhe unë nerva, momente rënie, ato errësirat që në publik i fsheh.

A ke frikë nga përsëritja?

Prej disa kohësh kam filluar të eksperimentoj me muzikën, edhe me zhanre që deri tani nuk i kam bërë. Kjo ka ardhur nga fakti që më është dukur vetja i përsëritur në disa projekte. Mendoj se është mirë të krijosh një identitet, por duhet të kesh kujdes edhe nga përsëritja e tepërt.

Çfarë ke humbur nga jeta “normale” (jo publike) për shkak të karrierës?

Kam sakrifikuar jetën sociale. Pak nga kompleksi i të qenit i vëzhguar kudo, dhe pak për të ruajtur ekskluzivitetin e skenës. Mund të fus këtu të dalën nëpër klube, por kur vjen puna për udhëtime apo kënaqësi të tilla, nuk e le mangët.

Sakrificat më të vështira në rrugëtimin tënd?

Më është dashur të bëj disa kompromise për hir të karrierës dhe mundësive që kam pasur. Dikur betohesha se nuk do të dilja kurrë në skenë gjysmë-playback, pa bandë live. Kam refuzuar aq shumë vende që më ftonin, sepse nuk e mundësonin dot anën teknike për të qenë live, apo për shkak të pagesës së lartë që ka banda. Më vonë e kuptova që duhet të lëshoj pak pe, dhe të përshtatem. Kjo më ka rritur profesionalisht dhe më ka bërë të punoj më fort.

Çfarë do të thotë për ty autenticitet në muzikë?

Është nevojë, për të mbetur në memorien e njerëzve. Mendoj që gjërat autentike “jetojnë” më gjatë.

Çfarë të frikëson më shumë në sukses?

Çfarë vjen pas. Nuk e kam arritur akoma atë që kam në mendje dhe pasi ta arrij nuk jam i sigurt çfarë vjen pas.

Çfarë do të ndryshojë në industrinë muzikore shqiptare?

Ka pafund gjëra për t'u ndryshuar, por më jepni pak kohë (qesh). Përtej shakasë, ka probleme që në performancat live, mungesa e platformave promovuese reale për artistët e rinj. Nuk i jepet vëmendje artistëve të veçantë, dhe kjo sjell që shumica të ndjekin shembujt e suksesit të artistëve aktualë, duke u bërë kopje. Nuk po vazhdoj më shumë, por ka shumë probleme (qesh).

A ke ndërë ndonjëherë presion për të ndryshuar stil për tregun?

Po, por është normale, sepse e vërteta është që me eksperiencë, edhe unë kam ndryshuar, kështu që dhe stili ndryshon. E rëndësishme është që, nëse ndryshon stili, të jesh përsëri vetja jote, jo dikush që është. (Nuk ka nevojë për një të dytë si “i suksesshmi”)

A ka rivalitet të shëndetshëm në këtë industri?

Ka artistë që po ndjekin një mënyrë shumë cilësore, po e ngrenë karrierën bashkë me nivelin. Kjo bën që unë të punoj më fort. Kështu që rivaliteti i shëndetshëm është ai që na duhet të gjithëve për t'u rritur.



*Sukcesi është më I SHTRENJTË,
në të gjitha KUPTIMET e fjalës.
Fama sot është pak më e thjeshtë
për SHKAK të mundësive
që të japin shumë platforma,
si RRJETET sociale apo
edhe programet televizive.
SUKSESI kërkon shumë
mundim, vullnet dhe DISIPLINË*

**Çfarë të relakson më shumë pas një koncerti?**

Zakonisht jam në rrugë duke u kthyer dhe ajo rruga me makinë më shijon shumë.

Çfarë bën kur nuk bën muzikë?

Në jetën time është primare deri tani që pjesën e lirë aq pak sa është, merrem me aktivitet fizik, dhe kur mundem takoj njerëzit që dua të cilët nuk i takoj shpesh.

Çfarë përfaqëson studio për ty: punë apo terapi?

Për mua puna është terapi, kështu që të dyja bashkë. Por, fakti që bëj punën që dua, e bën terapinë shumë më të vlefshme.

A preferon të punosh vetëm apo me ekip?

Kur shkruaj shumicën e kohës jam më mirë vetëm, por në përgjithësi me ekip preferoj të punoj sepse ka gjithmonë rezultate më të mira.

Cila është pjesa më e vështirë apo më e bukur e procesit krijues për ty?

Teksti është ajo që më duket pjesa më e vështirë, por kur vjen, vjen, dhe aty është momenti më i bukur. Pra, momenti i parë i krijimit të këngës, që ne e quajmë demo, është më i bukur. Momenti që kam më shumë bezdi është të xhiroj videot. Aty jam jashtë komfortit tim total.

A do ta konsiderojë ndonjëherë pjesëmarrjen në një ‘reality show’? Pse po ose pse jo?

Varet çfarë ‘reality show’ bëhet fjalë. Nëse flitet për “Big Brother” apo të ngjashëm, nuk e mendoj se jam i përshtatshëm. Por, nuk them kurrë.

Çfarë mendon se do të ishte sfida më e madhe për ty në një format të tillë?

Të jetoj me njerëz që nuk do t'i duroj dot, të ruaj veten që mos të reagoj ashtu siç nuk më njihni.

A duhet artistët të ‘shfrytëzojnë’ një format reality për të treguar veten përtej artit?

Nuk do të thosha duhet, por është mundësi shumë e mirë për shumë artistë apo njerëz të tjerë që të promovohen, të bëhen të famshëm.




Pranverë/Verë
 '26

Trend, *stil*
 autentik

*Nga dominimi i ngjyrës
 vjollcë te vijat, ndikimi
 i viteve '90 dhe veshjet
 transparente. Përgatitni
 gardërobën tuaj për ditët
 e ngrohta të pranverës, me
 një stil autentik.*

VIJAT

Vijat vijnë e shkojnë në veshjet e meshkujve. Këtë sezon ato do të shfaqen nga xhaketat te këmbët dhe aksesorët, pse jo edhe një pamje nga koka te këmbët me vijzime.




VITET '90

Një vështrim i rafinuar mbi nostalgjinë e viteve 1990, me silueta ekstreme, përmasa të personalizuar dhe luksoze, me ndikimin e estetikës dhe materialeve të rrobaqepësisë.

VJOLLCË

Krejtësisht ose pjesërisht vjollcë, mund të zgjidhni nuancat e forta ose tonet e buta. Shijoni këtë pranverë të gjitha variacionet e saj, për një pamje plot dritë dhe vibruese.



TRANSPARENTE

Ajo është arma përfundimtare e joshjes mashkullore. Këmisha plotësisht transparente që vishen direkt mbi lëkurë, me një prekje provokuese dhe sensuale.

Dielli bie thikë mbi Kanalin e Madh. Pamja e Vencias nga dritaret gotike të apartamentit të Diane von Furstenberg duket magjike. Apartamenti gjendet në katin e parë të një pallati mahnitës, me mure të mbuluara me stuko dhe afreske baroke, ndërsa nga tavanet lëkundën llambadarë gjigantë prej qelqi Murano. Çdo dhomë është e mobiluar me vepra të Pierre Paulin dhe Frank Gehry, ndërsa nga një derë gjysmë e hapur, dallohen një seri grafikash të Warhol. Marc Jacobs hyn në holl dhe një detaj të tërheq menjëherë vëmendjen: thonj me manikyr të zi dhe blu të dekoruar me kristale. Për katër dekada, ai ka krijuar një stil unik në botën e modës, duke u kthyer në një brand dhe biznes fitimprurës, që e bëjnë stilistin 62-vjeçar, ndër njerëzit më të pasur me një portofol 200 milionë dollarë. Pas 40 vitesh karrierë, dikush mund të pyesë, brenda këtij triptiku, cili është Marc Jacobs? Ai e ka të lehtë të përgjigjet, duke kujtuar se gjithçka nisi nga ai djaloshi 15-vjeçar, i cili i fiksuar pas modës, nisi rrugëtimin fillimisht në butikun "Charivari" të viteve '80 në Manhattan. Pasi u diplomua nga Shkolla e Dizajnit Parsons në vitin 1984, ai u punësua menjëherë nga burri që do të bëhej partneri i tij në biznes prej kohësh, Robert Duffy. Një dyshe e cila themeloi po atë vit markën Marc Jacobs.

Evolucioni i Jacobs gjithmonë është nxitur nga një kuriozitet i pangopur drejt transformimit dhe rishpikjes, ndaj nuk e mohon se ky ka qenë gjithmonë esenca e karrierës së tij. Shpesh ai lidhet emocionalisht me modën e papërpunuar dhe të sinqertë e cila përkthehet në dizajnet e tij, duke krijuar veshje dhe aksesore që kanë të bëjnë me një ide ose që evokojnë një ndjenjë apo një vend. Por, sado instiktiv që ka qenë procesi i dizajnit të Jacobs, nga ana tjetër gjithë

karriera e tij është një libër strategjik në industrinë e modës. Përtej markës me emrin e tij, Jacobs vazhdoi të punonte për të tjerë, së pari për Perry Ellis dhe më pas pranë Louis Vuitton, një eksperiencë që ai e quan si xhevahirin e kurorës së tij, pasi ishte amerikani i parë që drejtoi një markë luksoze franceze. Ashtu si John Galliano te Dior, figura e Marc Jacobs pranë LVMH Fashion Group u konsiderua si një rrezik, pasi gjithnjë ka pasur një paragjykim të stilistëve francezë karshi atyre amerikanë dhe qasjes së tyre në botën e modës. Por rreziku ia vlejti; zgjedhja e stilistëve nga markat e pavarura, arriti të diversifikojë markat tradicionale të modës evropiane drejt trendeve 'ready to wear'. Suksesi e identifikoi sakaq Jacobs me ndryshime, siç ishte modifikimi i monogramit klasik LV apo krijimin e aksesoreve revolucionarë, si çanta Sprouse Speedy, që konsiderohet si "Graal" më i lakmuar duke vendosur një standard të ri për markën luksoze.

Tipar dallues i Jacobs është dimensionimi fashion dhe komercial, i frymëzuar nga bota e kinemasë dhe muzikës, duke ftuar në fushatat e tij publicitare personazhe të cilët u kthyen në imazh për markat e modës, çka nxiti ndërtimin e strategjive të reja të

marketingut. "Disa prej personazheve VIP kanë qenë imazhe komerciale mjaft dominues, sepse janë figura të cilat kanë ndikim në marketing. Po ashtu, shumë prej tyre janë një busull orientimi sepse imazhi lidhet me brand-e të caktuara", shpjegon Jacobs. Në sfilatat e modës së Jacobs ka evoluar dukshëm elementi teatral, duke ndikuar dukshëm në kulturën pop.

Ndaj shpesh në rrafshin e rishpikjes, Jacobs ka revolucionarizuar elemente të modës, nga jakat e buta të rrumbullakosura te bluzat me bel të prerë të ndikuara nga stili i viteve '60. Momenti që e ktheu atë në qendër të vëmendjes dhe para një audience në rritje pas personazheve të famshëm, ndodhi në vitin 2005, kur çanta e tij Stam, u shfaq në duart e modeles Jessica Stam, e pastaj emra si Lindsay Lohan dhe Beyoncé u shfaqën krahas stilistit, duke e mbështetur hapur krijimtarinë e tij. Tre vjet më pas, Miley Cyrus, Kendall Jenner, Victoria Beckham dhe Lady Gaga debutuan në pasarelën e Jacobs duke e mbështetur hapur krijimtarinë e tij. Ndikimi u vu re aq shumë sa nisi të kthehej në një personazh që u bë pjesë edhe i serialit "Simpsons".

Përtej famës dhe suksesit, jeta private dhe varësia ndaj lëndëve narkotike shpesh e kanë kthyer në qendër të vëmendjes mediatike.

"Mbaj mend që kur disa media shkruan për mua gjëra shumë të dhimbshme, u trishtova shumë. Problemet me varësinë dhe periudha në qendrat e rehabilitimit ishin një çast reflektimi, duke paguar çmimin e veprimeve të mia", pohon stilisti.

Ashtu si në fillimet e tij, moda ishte vendi ku gjeti shpëtim. "Në këtë kohë të gjithë miqtë ishin të shqetësuar; por unë mbijetova dhe moda ishte absolutisht ajo që më shpëtoi. Jam me fat që jetoj në një univers kaq të bukur dhe krijues prej 40 vjetësh".

Përpos sfidave që ka kaluar

për 40 vjet, ajo që e bën Jacobs të ndihet ende i gjallë në botën e modës, por njëkohësisht edhe të pangopur, pasionant dhe krijues si në ditën e parë, lidhet me rishpikjen e gjithçkaje. Kjo u tregua qartazi në koleksionin Pranverë 2025, ku ai arriti t'i shndërronte disa nga veshjet e krijuara 10 vite më parë në një tjetër dimension, duke konfirmuar se stilisti vijon ende të jetë i frymëzuar për të realizuar projekte të paparashikuara. Që nga viti 2016, Marc Jacobs i ka bashkangjitur hashtagun #gratefulnothateful pothuajse të gjitha postimeve të tij në Instagram - një kujtesë për të përçafuar pozitivitetin para së gjithash.

Tani, në vend që të shkruajë fjalë të këqija, Jacobs dëshiron të përqendrohet vetëm te gjërat e mira. "E kontrolloj veten dhe mendoj: Ji mirënjohës që ke miq të mirë. Ji mirënjohës që ha mirë dhe që i sheh këto gjëra që janë pjesë e jetës tënde", thotë ai. 40 vitet e karrierës së tij kanë transformuar botën dhe vetë stilistin, ndaj Jacobs ndihet i lumtur që për katër dekada ka lënë gjurmën e tij - jo thjesht duke krijuar veshje dhe aksesore, por duke i konsideruar ato vepra arti të cilat kanë dhuruar emocione te njerëzit, energji pozitive dhe një univers të mbushur plot ngjyra...!

Superdizajneri

MARC JACOBS





Prekje artizanale

Mos u joshni më nga objektet me stil të rafinuar dhe super luksoze, pasi objektet dekorative që sjellin gjithnjë frymëzim nga bota artizanale, janë trendi i momentit në botën e interior dizajnit. Mund të zgjidhni karrige të thjeshta, ose kolltukë me frymën vintage, rafte dhe dollapë me nuancat e tokës, të ndërtuara me material bamboje ose elemente të kulturës industriale, vazo me vizatime fëmijnore apo instalacione me elemente prej metali, në nuanca të arta ose argjendta, të gjitha të vendosura në një konotacion artizanal, pasi ajo ka aftësinë t'i bëjë shtëpitë tona të duken të ngrohta dhe mikpritëse.



Nxirrni P JATAT RETRO

Një nga tendencat e artit të dekorimit të tavolinave gjatë viteve të fundit janë pjatat me dekore lulesh. E ndikuar nga estetika retro dhe vintage, duket se sipërfaqet e pjatave mbulohen më së shumti me motive nga bota floreale, e cila mbetet gjithmonë në modë, pavarësisht kohës. Ndaj gjithçka ju vjen në mend nga kuzhina e gjyshes, mund ta nxirrni dhe të shërbeni me to, pjata nga ato të antipastave deri tek ëmbëlsirat, duke i kthyer drekat familjare akoma në më të ngrohta. Po ashtu, pjatat ngjyrëshe dhe ato me stilin aziatik, janë shumë të dashura, duke u kthyer në objekte dëshirash për çdo amvisë.

Gruaja, tradita dhe shija me



NJË MENU QË FLET PËR FORCËN DHE FINESËN

Historia e 8 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas – është një rrëfim i gjatë për dinjitetin, përpjekjen dhe të drejtën për t'u dëgjuar. Nga fillesat e saj si lëvizje shoqërore, kjo datë është shndërruar në një simbol universal të barazisë dhe respektit për rolin e gruas në shoqëri. Në Itali, kjo festë njihet si "Festa della Donna" dhe shoqërohet me një simbol të veçantë: lulja e mimozës, e zgjedhur jo për luksin e saj, por për thjeshtësinë dhe forcën që përfaqëson. Përtej historisë zyrtare, 8 Marsi jeton në dimensionin e përditshëm të familjes. Sepse figura e gruas është e pandarë nga tryeza. Jo sepse ajo "duhet" të jetë aty, por sepse historikisht ka qenë zemra e saj: ajo që ka ruajtur shijet, recetat, traditat dhe kujtimet familjare. Nga gjithë që gatuanin pa masa dhe pa receta të shkruara, të nënat e sotme që përpiqen të balancojnë punën, kohën dhe kujdesin për familjen, kuzhina mbetet një hapësirë simbolike e dashurisë së heshtur dhe e përkushtimit të përditshëm.

Në këtë frymë, "Conad Albania" e sheh 8 Marsin jo thjesht si një datë festive, por si një moment reflektimi dhe nderimi. Me rrënjë italiane dhe me një identitet të ndërtuar mbi vlerat e tryezës dhe bashkimit familjar, "Conad Albania" synon të ofrojë produkte që i lehtësojnë jetën gruas moderne, pa ia hequr kuptimin ritualit të gatimit. Gatimi nuk është vetëm proces praktik, por një gjuhë: një mënyrë për të transmetuar kujtesë, për të ruajtur traditën dhe për të ndërtuar lidhje mes brezave. Menuja e propozuar për 8 Marsin nuk është thjesht një listë pjatash, por një rrëfim gastronomik që bashkon elegancën italiane me ndjeshmërinë e kësaj dite. Ajo ndërtohet si një dialog mes forcës dhe finesës, mes shijes së thellë dhe butësisë, dy dimensione që shpesh bashkëjetojnë në identitetin femëror.



PËRBËRËSIT:

300 g asparag, 2 vezë, 300 g Ricotta di Buffalo Campania DOP nga Saporì & Dintorni Conad, 14 bishta karkalecash nga Conad, 12 feta të holla Guanciale nga Saporì & Dintorni, 50 g djathë parmixhano, Vaj ulliri ekstra i virgjër Terre di Bari Bitonto DOP Saporì & Dintorni Conad, kripë, piper, mente e freskët dhe lule vjollca të ngrëshme.

PETULLA ME RIKOTA, KARKALECA, ASPARAG DHE LULE TË NGRËNSHME

Një antipastë elegante që feston aromën e freskëta të pranverës, duke kombinuar shijen e karkalecave me asparagun, duke i dhënë kësaj pjate një harmoni të përsosur midis tokës dhe detit.

PËRGATITJA:

Pastroni dhe hiqni lëkurën e asparagëve, hiqni mënjane majat dhe kërcejtë vendosini në frulator me vaj dhe kripë, derisa të krijohet një masë kremoze. Ndërkohë në një tas përziejini rikotën me vezët, djathin parmixhano, menten e freskët të grirë imët bashkë me disa copa karkalecash të prera në kubikë.

Masën e krijuar vendoseni në disa forma të lyera me gjalpë, pastaj vendosni sipër majat e prera të asparagut dhe piqini në banjë-mari në furrë në temperaturë 170 gradë Celsius për 25 minuta.

Ndërkaq, mbështillni karkalecat me proshutë dhe kalojini për skuqje në një tigan të nxehtë me pak vaj.

Vendosni petullat e pjekura në pjatë, shtoni bishtat e karkalecave, majat e asparagut, kremin e asparagut, si dhe lulet e vjollcës.

PËRBËRËSIT:

300 g salsicë derri, 500 g spaghetti alla chitarra nga Saporì & Dintorni Conad, 250 g kërpudha porçini të plota Saporì & Idee Conad, gjalpë, 1 tufë bimësh aromatike, 1 qese shafra, 1 thelb hudhër, djathë parmixhano, kripë dhe piper.



SPAGETI ALLA CHITARRA ME KËRPUDHA PORÇINI, SALSICË DHE SHAFRAN

Një pjatë e parë që feston përbërësit e shijshëm dhe aromatikë. Spagetit me strukturën e tyre të ashpër dhe poroze, thithin shijet e kërpudhave porçini, shafraanit dhe salsicës, duke krijuar një kombinim të shijshëm dhe të rafinuar.

PËRGATITJA:

Thërrmoni salsicët dhe skuqeni në një tigan derisa të gatuhet mirë, pastaj hiqini nga zjarri dhe lëreni mënjane. Në të njëjtin tigan, skuqni hudhërën me një copë gjalpë dhe erëzat.

Më pas shtoni kërpudhat porçini të prera në kubikë dhe skuqini në zjarr të lartë, derisa të gatohen plotësisht. Në fund shtoni salsicët.

Në një tenxhere me ujë të kripur, shtoni pluhurin e shafraanit dhe zieni spagetit, sipas kohës që përshkruhet në paketim. Pasi të jenë zier, hidhni spagetit në tiganin me kërpudhat dhe salsicën, shtoni një copë gjalpë, djathin parmixhano dhe përziejini.

Shërbejini me salcën e kërpudhave dhe salsicëve, pak piper dhe erëzat aromatike.

KARKALECA KATALANAS

Një pjatë kryesore me prodhime deti të freskëta dhe të shijshme, e cila falë kombinimit të karkalecave argjentinas, agrumeve, perimeve krokante dhe ullinjve aromatikë, krijon një shije ku gërshetohet ëmbëlsia e detit dhe aroma mesdhetare.



PËRBËRËSIT:

300 g karkaleca argjentinas Saporì & Idee Conad, 1 limon, 2 portokalle, 2 qepë të njoma, 2 kërcej selino, 60 g ullinj Taggiasca nga provinca Imperia në vaj EVO Saporì & Dintorni Conad, 250 g domate Pachino IGP Italia nga Saporì & Dintorni Conad, vaj ulliri ekstra i virgjër për shije, borzilok dhe kripë.

PËRGATITJA:

Kaloni për pak sekonda karkalecat në ujë të kripur dhe më pas gatuajini. Një pjesë lëri në plota dhe pjesën tjetër pritini në copa më të vogla. Pritini imët qepët e njoma, selinon dhe domatet në katër pjesë dhe më pas vendosini të gjitha në një tas të madh. Shtrydhni lëngun e limonit dhe portokallit, hidhni të gjitha në një tas me pak kripë dhe emulsifikojini me vaj ulliri ekstra të virgjër, derisa të përftoni një salcë aromatike. Përziejini të gjithë përbërësit dhe shtoni ullinjët. Shërbejini duke dekoruar pjatën me gjethe borziloku.

TORTA MIMOZA

Torta Mimoza nuk është thjesht një ëmbëlsirë, është një simbol i dashurisë, kujdesit dhe forcës së gruas. Krijuar në mes të shekullit XX nga kuzhinieri italian Adelmo Renzi në Rieti, ajo u bë e famshme kur u prezantua dhe fitoi në një konkurs pastičerie në Sanremo. Emri dhe pamja e saj i përkasin lules së mimozës, simbolit të Ditës së Gruas: e ndritshme, e thjeshtë dhe e fortë në të njëjtën kohë. Pamja e saj karakteristike, e mbuluar me copa të vogla pandespanje që imitojnë lulet e mimozës, e bëri këtë tortë menjëherë të dallueshme dhe të dashur. Suksesi i saj ishte aq i madh, saqë receta origjinale nuk u bë kurrë publike nga krijuesi, duke lënë hapësirë për lindjen e shumë varianteve në vite, nga versionet më tradicionale deri tek interpretimet moderne. Në çdo copë të tortës Mimoza jeton përkushtimi dhe delikatesa e figurës femërore, një mënyrë e ëmbël për të thënë “faleminderit”.

PËRGATITJA:

Vendosni vezët e plotat dhe sheqerin në një tas dhe rrihi me një mikser elektrik për 10-15 minuta, derisa përzjerja të fryhet. Më pas shtoni të verdhat e vezëve dhe rrihi për 5-6 minuta të tjera. Pastaj, shtoni miellin dhe niseshtenë, duke i përzier butësisht me një spatula nga poshtë lart. Hidhni brumin në dy tava me diametër 22-24 cm të ljera me yndyrë dhe spërkatur me miell dhe piqueni në furrë të parangrohur në temperaturë 180 gradë Celsius për rreth 30 minuta. Pasi të jenë pjekur, pandespanjat vendoseni mbi një letër furre derisa të ftohen.

Për përgatitjen e kremit, vendosni fillimisht qumështin në një tenxhere, pastaj shtoni kremin dhe lëreni të vlojë. Në një tenxhere tjetër, kombinoni të verdhat e vezëve, sheqerin dhe përziejini me një lugë druri. Shtoni miellin dhe farat e vaniljes, duke i përzier ngadalë. Pastaj shtoni qumështin dhe kremin dhe vazhdoni t'i rrihi me rrahëse dore. Kremin vendoseni në zjarr, lëreni derisa të trashet dhe kur të pluskojë, hiqeni nga zjarri. Hidhni kremin në një enë të cekët dhe të gjerë, mbulojeni me qese plastike dhe vendoseni në frigorifer.

Vazhdoni me përgatitjen e shurupit fillimisht duke shkrirë në një tenxhere mbi zjarr sheqerin, ujin dhe likerën. Pasi sheqeri të jetë shkrirë, hiqeni nga zjarri dhe lëreni të ftohet.

Ndërkaq, rrihi kremin e ftohur me një mikser elektrik dhe sapo të fillojë të shkumëzojë, shtoni sheqerin pluhur. Vazhdoni procesin për pak dhe në fund marengën vendoseni frigorifer. Pasi kremi i pastičerisë të jetë ftohur, transferojeni në një tas. Përhapi butësisht me një shpatull duke e përzier me marengën, ndërsa dy lugë nga masa hiqini mënjane.

Dy pandespanjat ndajini me thikë në tri pjesë me madhësinë e unazës që do të përdorni për ta montuar me trashësi, rreth 1 centimetra. Pjesën e mbetur priteni në shirita dhe më pas do ta pritni në forma kubike.

Montoni tortën, duke vendosur diskun e parë të pandespanjës të cilin e kemi zhytur më parë në shurup. Pasi ta vendosni shtroni një shtresë krem duke e përhapur me lugë. Sipër vendosni diskun e dytë të pandespanjës, duke e përsëritur procesin derisa të arrini diskun e tretë. Kur të ketë mbaruar montimi, dy lugët e mbetura të kremit përhapini sipër me anën e një spatule. Pasi torta të jetë mbuluar me krem, dekorojeni gjithë sipërfaqen me kubet e vogla sipër pandespanjës. Në mënyrë që kubat të ngjiten mirë, vendoseni tortën në frigorifer duke e mbuluar me një kapak qelqi. Shërbejeni të spërkatur me sheqer pluhur dhe kokrra boroniceje.

PËRBËRËSIT PËR KATËR PERSONA:

Për pandespanjën:
4 vezë të plotat, 8 të verdha vezësh, 200 g miell, 200 g sheqer, 40 g niseshte, një majë kripë.

Për kremin:
300 ml qumësht, 300 ml krem i freskët, 200 g sheqer, 50 g miell, 8 të verdha vezësh, gjysmë bishtajë vaniljeje.

Për shurupin:
100 ml ujë, 50 ml Cointreau ose Alchermes, 50 g sheqer.
Për kremin e marengës:
200 ml krem të freskët, 20 g sheqer pluhur.



“LAKURIQ” NGA OLTSSEN GRIPSHI

#NGA BRUNILDA GOROVELLI

Oltsen Gripshi rikthehet me ekspozitën “Lakuriq”, një projekt i guximshëm që zhvesh trupin nga klishtë dhe e kthen në hartë të shpirtit njerëzor. Në hapësirën e “Gallery of Contemporary Art Tirana”, artisti eksploron lakuriqësinë jo si provokim estetik, por si përvojë filozofike, antropologjike dhe thellësisht njerëzore.

Si lindi ideja për ekspozitën “Lakuriq”?

Ideja për ekspozitën “Lakuriq” lindi nga kërkimi im i vazhdueshëm mbi ekzistencën e qenies njerëzore, që përbën thelbin e krijimtarisë sime si artist i artit bashkëkohor. Në këtë ekspozitë, lakuriqësia trajtohet si një fenomen shqisor, gjithëpërfshirës dhe shumëplanësh, që shkon përtej trupit si subjekt dhe hap një reflektim mbi ekzistencën në tërësi. Në bashkëpunim me kuratorin italian Massimo Scaringella dhe me drejtoreshën artistike të ekspozitës të “GOCAT”, Ena Bulku, jam thelluar në ndjeshmëritë e mia për të zbuluar qenien njerëzore në disa përmasa. Qëndrimi përballë një trupi lakuriq shndërrohet në një gjendje ekstaze, pothuajse në një ndërlidhje hyjnore, ku artisti shpërbëhet

në shumësi ndjesish brenda vetes. perceptimi i lakuriqësisë merr një përmasë semiotike, rreth të cilit ndërthuren të gjitha përmasat e ekzistencës: erotizmi, dashuria, joshja, eksitimi, lartësimi shpirtëror, përkatësia territoriale, socializimi dhe antropologjia e frymës.

Pse zgjodhët pikërisht këtë titull?

E zgjodha sepse dëshiroja ta vëzhgoja dhe ta përjetoja qenien njerëzore ashtu siç është në thelb: pa zbulime, pa kamuflime dhe pa deformime në të vërtetën e saj të zhveshur. Kjo qasje më rikthen për analogji në mënyrë simbolike te zanafilat, te figura e Adamit dhe Evës, të cilët përfaqësojnë kalimin e njeriut nga gjendja instinktive drejt vetëdijes. Lakuriqësia e tyre nuk shënon mëkat, por momentin e ndërgjegjësimit, marrjen e përgjegjësisë dhe fitimin e vullnetit të lirë, fillimin e rrugëtimit të njeriut drejt dijes.

Çfarë do të donit që publiku të ndiejë kur sheh veprat?

Në këtë proces osmozë midis “gjenit” krijues brenda artistit dhe nevojës për të shijuar e për t’u joshur nga bukuria rrezatuese e lakuriqësisë, është semantika e gjuhës së përdorur nga artisti në komunikim me masën. Në këtë fushëpamje, ajo që dëshiroj që publiku të ndiejë kur gjendet përballë çdo veprë të ekspozuar në hapësirën e GOCAT është krijimi i një dialogu tërësisht vetjak, pa u ndikuar aspak pavarësisht shpjegimit që unë jap në secilën veprë. Kjo, sepse dëshiroj që publiku ta shohë dhe ta perceptoj lakuriqësinë si “hartën e shpirtit”, të ekzistencës së qenies njerëzore antropo-fenomenologjike.

Sa kohë ju mori përgatitja e kësaj ekspozite?

Të realizosh një ekspozitë nuk është lehtë, për më tepër kur ajo është e konceptuar dhe e konkretizuar me gjuhën e artit bashkëkohor. Kjo, pasi kërkon një proces hulumtimi teorik që më pas të shpjen në përmasën përmbajtësore, duke e shfaqur atë përballë publikut në një hapësirë ekspozuese. Përgatitja u ngjiz para dy vitesh si një përballje me konceptin e lakuriqësisë për ta hetuar dhe depërtuar në shumë drejtime si mënyra e vetme për ta kuptuar dhe çliruar atë nga hermetizmi i druajtjes. **A ka një veprë që ka një domethënie të veçantë për ju?**

Të gjitha veprat e “Lakuriq” mbartin ngarkesë të fortë simbolike, pasi hulumtojnë njeriun në përmasat e tij si ekzistencë konkrete, pjesë e një realiteti fizik dhe shoqëror. Ndër to, veçoj veprën “Metafora e përmbajtjes”, e cila me një gjuhë konceptuale pamore trajton pozitën e gruas në shoqërinë bashkëkohore, duke vënë në pah brishtësinë e saj përballë strukturave patriarkale, dhunës dhe mungesës së barazisë. Në këtë veprë, trupi femëror nuk paraqitet si figurë individuale, por si një prani kolektive, një shumësi zërash të heshtur që kërkojnë të shpërfaqen, të dëgohen, të pranohen dhe të vlerësohen.

A është kjo ekspozitë është ndryshe nga punët e mëparshme?

Kjo ekspozitë përfaqëson një kthesë të qartë në raport me ekspozitat e mëparshme. Rrugëtimi im jetësor dhe artistik më ka çuar drejt një pjekurie më të thellë konceptuale dhe më ka dhënë guximin të trajtoj tema komplekse, si lakuriqësia në përmasën e saj filozofike dhe ekzistenciale. Kjo pjekuri shprehet qartazi në veprën “Epistemotopografia qelizore”, e cila paraqet një kërkim filozofik mbi trupin. Lëkura nuk trajtohet vetëm si kufi biologjik, por si një hartë njohjeje dhe si territor ku regjistrohen gjurmët e botës shpirtërore e psikike të individit bashkëkohor. Kjo thellësi reflektive dhe qasje e re konceptuale e bëjnë ekspozitën “Lakuriq” thelbësisht të ndryshme nga krijimet e mia të mëparshme.

GIRLS TRIP ME “PERLAS TRAVEL”

KU MIQËSIA, QESHJET DHE AVENTURAT BASHKOHEN

Ka pak gjëra më magjike sesa një udhëtim me shoqet e zemrës. Të qeshurat që nuk ndalen, bisedat që zgjasin deri vonë, koktejet e shërbyera me stil dhe ditët e plazhit ku koha duket se ndalon – një Girls Trip nuk është thjesht pushim, është një përvojë që krijon kujtime që do t’i mbani përgjithmonë. “Perlas Travel” ju sjell tre destinacione të përzgjedhura me kujdes, secila me një atmosferë unike, ku çdo paketë mund të personalizohet sipas dëshirës dhe kërkesave të grupit tuaj, duke e bërë udhëtimin unik dhe të përshtatur për çdo shoqëri.



SANTORINI, GREQI – RELAKS, SUNSET DHE MAGJIA E EGJEUT

Që në momentin kur arrini në Santorini, ndjeni se diçka ndryshon. Ajri i freskët detar, drita e arit që reflektohet mbi kupolat blu dhe kalldrëmet e bardha krijojnë një atmosferë që fton në relaks dhe frymëzim. Ky destinacion është i përsosur për ato që kërkojnë qetësi, pamje panoramike dhe momente për t’u kujtuar. Ditët mund të fillojnë me një kafe në një rooftop me pamje nga deti, të vazhdojnë me plazhe të qeta ku mund të lexoni ose të flisni me shoqet për orë të tëra, dhe të mbyllen me sunset cocktails mbi ujërat blu që duken se shtrihen pafund. Paketat individuale të “Perlas Travel” ju lejojnë të personalizoni aktivitetet sipas dëshirës së grupit, duke përfshirë spa, guida lokale ose eksperiencat unike në plazh.



LISBONË, PORTUGALI – AVENTURË URBANE DHE ENERGJI QË NUK NDALET

Për shoqet që duan lëvizje dhe eksperiencat urbane, Lisbona është zgjedhja ideale. Nga rrugicat e ngushta të Alfamas e deri te kafenetë e modës në Bairro Alto, çdo hap është një zbulim i ri. Udhëtimi me tram klasik, ecjet mbi kalldrëmet e qytetit, vizitat në dyqane të vogla artizanale dhe sunset cruise mbi lumin Tagus krijojnë një përvojë urbane që kombinon historinë, stilin dhe argëtimin. Paketat e personalizuar mund të përfshijnë aktivitete kreative, guida private, degustime tradicionale ose itinerare spontane, sipas ritmit dhe preferencave të grupit. Lisbona është për ato që kërkojnë aventura spontane, foto perfekte dhe qeshje që nuk ndalen.

CÔTE D’AZUR / MONAKO – LUKS, ELEGANCË DHE EKSPERIENCA PREMIUM

Kur dëshironi të shkëlqeni dhe të përjetoni luks, Riviera Franceze ofron çdo detaj të pakrahasueshëm. Boutique hotels me pamje deti, yacht day trips dhe restorante elegante bëjnë çdo ditë të veçantë. Monako dhe Côte d’Azur janë destinacione ku çdo aktivitet, nga një drekë buzë detit të një mbrëmje me sunset cocktails, kthehet në një eksperiencë të rafinuar dhe të paharrueshme. Paketat individuale mund të përfshijnë villa private, chef personal, yacht trips të dedikuara ose itinerare me guidë, të gjitha të dizajnuara sipas dëshirës së grupit. Ky destinacion është ideal për ato që duan të kombinojnë luksin me shoqërinë dhe të krijojnë kujtime të rafinuara, të bukura dhe të paharrueshme.

PERLAS TRAVEL – AVENTURË E PERSONALIZUAR PËR ÇDO GIRLS TRIP

Çdo destinacion ka historinë e vet, por ajo që i bashkon është eksperiencat e përgatitura me kujdes nga “Perlas Travel”. Paketat janë individuale dhe mund të personalizohen në çdo detaj nga aktivitetet dhe itineraret tek akomodimi dhe eksperiencat e veçanta për t’i dhënë grupit tuaj një udhëtim unik dhe të paharrueshëm. Sepse një Girls Trip nuk është thjesht pushim, është aventura e miqësisë, e qeshjes dhe e momenteve që mbeten përgjithmonë. Rezervoni tani dhe përjetoni përvojën që meritoni!

Find us here



PERLAS TRAVEL & TOURS

Tiranë, Ish-blllok, Rruga “Pashko Vasa” Nr.75
Elbasan, Lagja “Luigj Gurakuqi” Rruga “Rinia”

perlastravel@yahoo.com

+355 069 73 66 055

+355 069 76 94 047



ZAKOPANE,

“LAPLANDI” NË ZEMRËN E EVROPËS

- “A ke qenë ndonjëherë në Zakopane? Njihet si ‘Laplandi’ i zemrës së Evropës”, - më tha një ditë dikush. - “Nuk ka mundësi”, - i thashë. - “Nuk ka të dytë në botë si Lapland”. - “Provo të shkosh e më thuaj më pas”, - tha përsëri ai djaloshi.

Më mbeti në mendje! Po bëja plane të shkoja në Zakopane, që realisht si pozicion është në cepin juglindor të Polonisë, shumë ngjitur me Sllovakinë, por gati 4 orë rrugë me shumë kthesa e dhimbje-koke nga Bratislava. Gjithsesi, bëra-ç'bëra dhe e pashë veten në Zakopane!

Zakopane!
 Kjo parajsë malore e Polonisë, shtrirë në këmbë të maleve Tatra. Një vend tipik malor, me pista skish, teleferik, lokale malore, shkolla skish për fillestarë apo dyqane pajime skish për qira. Për polakët, Zakopane është një destinacion shumë i preferuar pasi malet Tatras janë malet e vetme me karakter alpin në Poloni, me maja të thepisura dhe liqene akullnajore. Zakopane është qendra e lojërave dhe e sporteve dimërore. I kënaqshëm për të gjithë familjen: vendi ideal për fëmijët e vegjël, që nga argëtimet e akullit deri te “Luna Park”.

Ka disa gjëra të veçanta në Zakopane:

1- Në Parkun Kombëtar Tatra ndodhet Rysy (2 499 m) – maja më e lartë e Polonisë. Është një nga ngjitjet më ikonike për alpinistët. Fotot, muralet dhe skulpturat me alpinistë, duke ngjitur majat janë të zakonshme në gjithë qytetin.

2- Tatra National Park është shumë i strukturuar, nuk lejohet dalja jashtë shtigjeve të shënuara dhe ka kontroll serioz për ruajtjen e natyrës. Ka edhe arinj, rrëqebuj dhe dhi mali. Edhe dhitë duket të jenë simbol i qytetit.

3- Qendër arti dhe njerëz të “krisur”.
 Prej një shekulli, Zakopane është kthyer në një “koloni artistësh”. Shkrimtarë, piktorë dhe intelektualë polakë vijnë këtu për frymëzim. Dhe mbeten aty... nga veprat e tyre.

4- Djathi tradicional “oscypek” është produkti më i famshëm. Ky djathë prodhohet vetëm në këtë rajon sipas metodës tradicionale me boronicë. Duhet provuar medoemos!

5- Liqeni “Morskie Oko” (syri i detit).
 Liqeni Morskie Oko është liqeni më i njohur dhe më i fotografuar në Poloni. Shkohet me këmbë “hiking”, ku ka një shteg të asfaltuar rreth 8–9 km (vajtje) nga parkingu Palenica Bialczańska. Ecja është e lehtë, por e gjatë. Rrugës ka edhe karroca tradicionale me kuaj për një pjesë të saj. Dhe plot dyqane të vogla që të rrëmbejnë vëmendjen për të blerë suvenire.
 Emri i liqenit vjen nga një legjendë e vjetër, sipas së cilës ai ishte i lidhur nga nëntoka me detin. Në realitet është një liqen akullnajor, i formuar nga shkrirja e akullnajave mijëra vite më parë. Është aq i pastër e i kulluar sa në ditë të qarta duken majat e pemëve të pasqyruar në të, kurse në dimër ngrin i tëri, duke dhënë një pamje spektakolare. Nëse vendos që ta vizitosh, duhet gjetur një orar i përshtatshëm për të shmangur turmat.
 Sepse për polakët Zakopane, liqeni Morskie Oko dhe malet Tatra nuk janë një destinacion turistik por një simbol kombëtar, një kult, një gjë që kalon përtej madhështisë.

Çfarë të vizitohet në Zakopane:



- 1.** Krupówki Street.
 Rruga kryesore dhe më e gjallë e qytetit. Është një rrugë mbushur plot dyqane tradicionale, restorante me kuzhinë malore, pastičeri dhe muzikë live. Është zemra sociale e Zakopanes.
- 2.** Vila Koliba, Muzeu i Stilit të Zakopane.
 Shtëpia e parë në stilin arkitekturor “Zakopane”. Shtëpitë janë prej druri dhe kjo i bën të veçanta e ia shton lezetin qytetit.
- 3.** Arena “Wielka Krokiew”.
 Arena e famshme e kërcimeve me ski. Edhe pa garë, mund të vizitohet dhe pamja nga aty është shumë e bukur.
- 4.** Gubałówka Hill.
 Ngjitja me funikular në pak minuta dhe aty ka një panoramë të plotë mbi Zakopanen dhe Tatrat. Është ideale për të gjithë ata që dëshirojmë pamje spektakolare.

5. Tregjet tradicionale.
 Në disa pika të qytetit shitet djathi oscypek, produkte artizanale çikërrima, suvenire dhe punime druri.

Tani që e kam parë Zakopanen, unë e di fare mirë pse e krahasojnë me Laplandin, ku në fakt gjeografikisht nuk janë farë të njëjta. Por kanë diçka që i bashkon. Dhe kjo është... kjo është...
 Secili duhet ta zbulojë vetë këtë!
 Zakopane mbetet një nga destinacionet më të bukura malore të Evropës.

Nga Zakopane,
 Eda Bano,
 shkurt 2026.





ENXHI NASUFI

VJEN ME LIBRIN “E FSHEHTA E SYVE TË TU”, NJË HISTORI DASHURIE PËRTEJ TË ZAKONSHMES!



Enxhi Nasufi, këngëtarja dhe moderatorja e njohur, vjen këtë herë për publikun në një dimension tjetër, atë të shkrimtares, ku me anë të penës së saj në bashkëpunim dhe me shkrimtarin Klajdi Thaçi sjellin romanin debutues “E fshehta e syve të tu”. Libri trajton konceptin e “twin flames”, shpirtrat binjakë ose shpirtrat pasqyrë, një temë pak e eksploruar, por thellësisht transformuese.

Sipas saj, libri nuk është një histori klasike dashurie. Ai rrëfen një takim që shkon përtej ndjenjës romantike, një lidhje që të përball me vetveten, me plagët dhe të vërtetat e tua më të fshehta. Edhe pse i frymëzuar nga një përvojë reale e jetës së saj, romani është ndërtuar si fiction, i përpunuar në mënyrë artistike, për t'i dhënë lexuesit hapësirë reflektimi dhe identifikimi. “Bordo” ishte pjesë e eventit promovues të librit, i cili u zhvillua në ambientet e kinemasë “Agimi”, ku të pranishmit patën mundësinë të shfletonin nga afër copëzat e shkruara nga Enxhi, shoqëruar me një autograf dhe një bisedë të shkurtër e të sinqertë. Atmosfera ishte elegante dhe e ngrohtë, ndërsa Enxhi nuk ngurroi të ndajë me të ftuarit edhe disa nota live të repertorit të saj muzikor që frymëzuan edhe rrëfimin e librit.

Eventi u zhvillua me prezencën e të dy autorëve dhe drejtueses së shtëpisë botuese DUDAJ, Arlinda Dudaj, e cila u shpreh se “gjithkush do të gjejë një copëz të historisë së vet”. Libri tashmë gjendet në çdo librari të Tiranës dhe Kosovës.

“PUZZLE TIRANA EXPERIENCE”,

AKTIVITETI MË I RI NË KRYEQYTET “KA NEVOJË” PËR NDIHMËN TËNDE!

Tirana Kryeqytet – “Puzzle Tirana Experience” është aktiviteti më i fundit që duhet të vizitoni dhe të lini shenjën tuaj në përmbushjen e një instalacioni domethënës dhe atraktiv. Projekti më i ri në kryeqytet parashikon realizimin dhe vendosjen e një puzzle-i të madh fizik, interaktiv, të përbërë nga 50 pjesë magnetike, i cili do të shërbejë si një instalacion artistik publik në hapësirë të hapur. Puzzle është konceptuar për t’u ndërtuar gradualisht nga qytetarët dhe turistët, duke krijuar në fund portretin artistik të Tiranës, si një simbol i bashkëpunimit, identitetit urban dhe përfshirjes qytetare.

Çdo pjesë e puzzle-it përfaqëson elementë vizualë të atraksioneve ikonike të qytetit dhe është e ndërtuar me materiale të qëndrueshme dhe të sigurta për përdorim publik. Për të rritur ndërveprimin dhe vlerën edukative, instalacioni do të pajiset me një sistem QR Code tematik, i cili do t’u mundësojë vizitorëve akses të menjëhershëm në informacionin përkatës në gjuhën shqipe dhe angleze, duke prezantuar historinë, rëndësinë kulturore dhe turistike të secilit atraksion të përfshirë në puzzle.

Puzzle përfshin gjithsej 10 atraksione kryesore të Tiranës, të përzgjedhura për vlerën e tyre historike, kulturore dhe simbolike për qytetin. Këto janë: Sheshi Skënderbej, Pazari i Ri, Blloku, Piramida, Liqeni Artificial, Mali i Dajtit, Muzeu Kombëtar, Katedralja “Ngjallja e Krishtit”, Xhamia e Namazgjasë dhe Kulla e Sahatit. Përmes kësaj përzgjedhjeje, projekti synon të paraqesë një panoramë të balancuar të Tiranës tradicionale dhe moderne.

Instalacioni do të vendoset pranë Bashkisë së Tiranës, në një zonë me fluks të lartë qytetarësh dhe turistësh, duke garantuar dukshmëri të lartë dhe akses të lehtë për publikun. Puzzle do të qëndrojë i ekspozuar për disa ditë dhe do të shoqërohet edhe me biskota të personalizuar, duke krijuar një pikë referimi vizuale dhe ndërvepruese në qendër të qytetit, si dhe një hapësirë të re për aktivitete kulturore dhe promovuese.



AKORDUESI I PIANOS

AUTORI: Chiang-Sheng Kuo
ÇMIMI: 1000 lekë

Një fëmijë me një talent të rrallë muzikor i lindur në një familje të varfër në Taipei, i vetëdijshëm se i ati nuk e kuptonte dhuntinë e tij dhe pa mundësi shkollimi muzikor, ai u rrit larg dritave të skenës dhe u bë akordues pianosh. Tashmë rreth të dyzetave ai ka humbur vendin e punës, pasi gruaja që drejtonte studion vdiq nga kanceri. Ai vazhdoi të kujdesej për pianot e prishura, derisa bashkëshorti i pasur vejan i graas së vdekur e dëgjon akorduesin, duke luajtur në piano me një tingull mahnitës, nga ai çast lind një bashkëpunim i paemër...

PËR POLINËN

AUTORI: Takis Würger
ÇMIMI: 1200 lekë

Në moshën 14-vjeçare, Hanes Prageri bie në dashuri me vajzën Polina. Për t'i treguar dashurinë, djali i bekuar me një talent të jashtëzakonshëm kompozon një melodi që përfshin të gjitha endjet dhe dëshirat e Polinës. Por jeta e tij merr një kthesë të paparashikuar. Hanesi pushon së luajturi piano, dhe rrugët e tij ndahen nga ato të Polinës. Pas vitësh të tëra, gjatë të cilave ai nuk ndjen asgjë tjetër përveçse boshllëk, Hanesi e kupton: duhet të rigjejë Polinën. Dhe e vetmja gjë me të cilën mund të arrijë atë është melodia e saj.



MUJ MJALTI NGA HALLI

AUTORI: Christina Lauren
ÇMIMI: 1300 lekë

Ndërsa motra e saj binjake Ami është personi më me fat dhe po martohet me burrin e ëndrrave, Olivës i duhet të sillet mirë me armikun e saj numër një, Etanin, shoqëruesin e dhëndrit. Aty fati i Olivës po ndryshon... Kur të gjithë dasmorët, me përjashtim të Olivës dhe Etanit, helmohen nga ushqimi, ata i pret një muaj mjalti në Hava'i. Edhe pse e urrëjnë njëri-tjetrin, nisen drejt paradisë, ku Oliva takon shefin e saj dhe ata detyrohen të luajnë rolin e të sapomartuarve. Ajo kupton se nuk e ka problem të luajë atë rol, sepse po i pëlqen...



E FSHEHTA E SYVE TË TU

AUTORI: Enxhi Nasufi
ÇMIMI: 1200 lekë

Një takim në dukje i rastësishëm mes Elorës dhe Elionit nis me një kryqëzim shikimesh që lë pas një ndjesi të pazakontë. Mes tyre krijohet një aftësi e çuditshme, që ngjan sikur vjen nga një njohje e hershme, jo nga një takim i parë. E udhëhequr nga intuïta e mprehtë, Elora nis të dyshojë se marrëdhënia që po lind nuk është e zakonshme. Elioni, përkundrazi, përpiqet t'i shpjegojë përkimet e njëpasnjëshme si rastësi. Në përpjekjen për të kuptuar këtë lidhje të paqartë, një rol të rëndësishëm luan Sibeli, psikologjia e përbashkët e çiftit.

DJEGIA

AUTORI: Srdan Srdić
ÇMIMI: 1500 lekë

Nëntë historitë e librit e vendosin lexuesin përballë brendisë së përditshmërisë, ku diku në provincë, takohet në formën më radikale me mungesën e shpresës dhe dëshpërimin e tranzicionit ballkanik. I përkushtuar ndaj angazhimit shoqëror dhe rrengjeve narrative, Srdić-i ia del ta shpërbëjë të tashmen në banalitete me të cilat jemi lodhur prej vitësh, deri në atë pikë sa të mos e dallojmë dot më thellësinë e mugëtirës brenda së cilës jetojmë. Historitë e Srdić-it janë gjuhësish të përkryera dhe autenticiteti u dallohet në mënyrë emblematike.



KANDIDATI I KREMLINIT

AUTORI: Jason Matthews
ÇMIMI: 1500 lekë

Presidenti Vladimir Putin, planifikon vrasjen e një zyrtari amerikan, që ta zëvendësojë me një agjent sekret rus. Kur e nuhat komplotin, Domenika dhe Nati duan të demaskojnë tradhtarin, para se të zbulohet se Dominika është agjente e CIA-s. Çdo rrjedhje informacioni do ta ekspozojë si një aset të tyre, gjë që do ta shpjerë në ekzekutime. Fijet bashkohen një fundjavë në rrethin e ngushtë të Putinit. A do të sakrifikojë veten Nati për të shpëtuar Domenikën? Ajo a do të dorëzohet për ta mbrojtur të dashurin? Apo do ta pësojnë të dy?

50 NGJYRAT E MIA...

NGA DOREADA MIO

50 vitet e mia janë shumë; janë gëzime të pafajshme fëmijërie, janë emocione të pas-tran rinie, adrenalinë me rrahje zemre në grykë; janë kujtime, net pa gjumë, pyetje pa përgjigje, vendime të vështira... përgjegjësi e ngarkesë që një grua i mban mbi supë.

Unë jam edhe hije, edhe dritë; hezitim dhe siguri; forcë dhe brishtësi. Unë jam një histori me shumë nuanca.

Unë jam shumë dhe nuk zvogëlohem për askënd dhe asgjë... Unë jam 50 ngjyra...

Çdo muaj, në këtë hapësirë të revistës "Bordo", do të ndalem te një emocion, një frikë, një reflektim mbi trupin, mendjen, vetminë, ambicien, plakjen, bukurinë, mbi të kaluarën dhe të tashmen. Nuk do të jap këshilla, as do të gjykoj; thjesht do të rrëfej përpara një pasqyre ku ndoshta do ta shihni veten edhe ju. Sepse secila prej nesh ka një pa-fundësi ngjyrash...

Aroma e vërtetë e 8 Marsit...

Sa herë kthej kokën pas në fëmijërinë time, muaji mars nuk mund të kuptohet pa datën 7 si Festa e Mësuesit, apo si "prindi i dytë" që na edukonte, si dhe 8 Marsi, festa e nënës. Në mëngjes, në shkollë, ne fëmijët i dhuronim mësueses kartolina e lule, më së shumti mimoza, pasi ajo çel në këtë kohë. Organizoheshin koncerte ku recitonim poezi e i këndonim dashurisë për mësuesit e nënat, sidomos nënat, për sakrificat që ato bënin... Duartrokitej për nënën që punonte, lindte, rriste fëmijët dhe mbante peshën e shtëpisë. Mbaj mend fjalën që përsëritej çdo vit: sakrificë. Grave u përmendej sakrificat si grua, si bashkëshorte, si nënë.

Ishte një fjalë që tingëllonte e bukur, por mua më shkaktonte një lloj bezdie e trishtimi dhe atëherë nuk e kuptoja dot pse. Por kur e mendoj sot, si grua e pjekur, e kuptoj se atëherë vlera e graas matej me sa shumë hiqte dorë nga vetja dhe sakrificat ishte

virtuti i saj kryesor... Po sot? A vazhdojmë të vetë-sakrifikohemi? A jemi vërtet më të lira?

Gruaja shqiptare ka ndryshuar shumë. Nuk është më ajo që pret një ditë në vit të festojë vetëm me gra, që kërcëjnë me njëra-tjetrën apo të shkojnë në ekskursion me shoqet. Ajo ka fituar arsim, zë, karrierë. Por bashkë me lirinë, sot ajo rrezikon të jetë e prangosur nga standardi i bukurisë, nga presioni për të qenë gjithmonë perfekte.

Dikur gruaja lavdërohej për forcën e për djersën që i ndrinte në ballë. Besoj të gjithëve ju kujtohet kënga: "Anës e pas anës o, lumit të fshatit tim, dalin vajzat trimëshra, djersa në ballë ju ndrin".

Sot ajo mund të ketë një ballë të mbushur me botox, por e rëndësishme është të mos ketë rrudha. Dhe këtu lind paradoksi i kohës sonë: Gruaja është më e lirë. Më e suksesshme. Por edhe më e pasigurt para pasqyrës.

Media sociale ka bërë që presioni estetik sot të jetë më i fortë se kurrë. "Miti i bukurisë" krijon idenë se sa më shumë përparon gruaja, aq më shumë rriten standardet e pamundurës për pamjen e saj.

Dhe në mes të këtyre dy realiteteve, unë kërkoj një 8 Mars tjetër, ku të mos jemi më as heroina të sakrificës, as sklave të perfekte, por gra që zgjedhim — si të jetojmë, si të dukemi. Dhe kjo, për mua, është aroma e vërtetë e 8 Marsit sot.

Gjatë kohës që shkruaja këto rreshta, kam ndier shumë të gjallë aromën e pastër të livandos që quhej "8 Mar-

si", e cila kishte një shishe të vogël qelqi. Ajo dhe një buzëkuq rozë kanë qenë dhurata për mamanë time, një 8 Mars të largët diku nga mesi i viteve '80. Mamaja ime hyn te grupi i grave që vërtet kanë sakrifikuar. Ndërkohë do të doja shumë që im bir të mos më shihte si një nënë që e ka rritur duke sakrifikuar, por si një grua që është rritur bashkë me të, pa hequr dorë nga ëndrrat e dëshirat e saj...

Dhe si përfundim, 8 Marsi është Dita Ndërkombëtare e Graas dhe jo dita e nënës; është ditë proteste, jo vetëm feste.



DASHI

Është më mirë ta filloni këtë muaj me qetësi. Prania e disa planetëve në shenjën tuaj sugjerojnë kujdes. Eklipsi Hënor hedh dritë mbi një ndryshim të mundshëm pune, ndërsa tekta Venusi hyn në shenjën tuaj ju dhuron sharm dhe një pamje joshëse. Thuajuni po aventurave të reja dhe përfshihuni në momente argëtuese. Paratë do të rriten, ndërsa shëndeti do të jetë i qëndrueshëm.

DEMI

Jeta juaj shoqërore do të jetë aktive që në fillim të Marsit, ndaj përfshihuni totalisht duke investuar në karrierën tuaj pasi pritshmëritë tuaja do të shpërblehen. Venusi në Dash rrit mundësinë e një romance të re, por mos u bëni ëndërrimtarë, pasi edhe për emocionet dashurore duhet të sakrifikoni. Dilni nga zona juaj e vetanalizës dhe lëreni veten në marrjen e vendimeve të befasishme.

BINJAKËT

Një gjendje e plogësht vjen te ju për shkak se planeti juaj sundues Mërkuri do të jetë retrogradë. Karriera juaj është në ngritje dhe pritet që disa projekte të reja do t'ju sigurojnë suksesin. Por, mos harroni që një ngjitje e shpejtë në majë mund të jetë edhe fatale. Muaji mbyllet me praninë e Venusit që qëndron në zonën tuaj të introspeksionit, ideale për tërheqje private dhe romanca.

GAFORRJA

Një muaj i mrekullueshëm për udhëtime, ose pushime të cilat do të mbushin më pas gjithë energji jetën tuaj. Shanset për të humbur qetësinë tuaj do të shumëfishohen, ndaj praktikoni durimin nëse doni të ruani qetësinë. Reputacioni juaj në karrierë do të marrë shkëlqim falë Afërditës e cila hyn në shenjën tuaj, ndaj shfrytëzoni atë. Për beqarët, koha ideale për njohje të reja.

LUANI

Nëse shpenzimet tuaja kanë qenë jashtë kontrollit, mund të shihni se ku duhet t'i ulni ato, ndaj merrni një qasje më kritike ndaj harxhimeve të tepërta. Planifikoni udhëtime romantike sepse Afërdita po lundron në shenjën tuaj dhe kjo është një kohë ideale për një muaj mjalti të dytë. Mërkuri në retrograde ju favorizon në karrierën tuaj, por mos e teproni me autoritetin tuaj.



PESHQIT

Ky do të jetë muaji dhe koha më e shkëlqyer e vitit. Një periudhë e cila kombinon suksesin në karrierë, raporte të mira personale dhe shumë dashuri. Venusi viziton zonën tuaj të financave për disa javë dhe duke filluar nga data 6, ju mund të investoni me siguri, qoftë në biznes, por edhe për të rifreskuar pamjen tuaj. Aventurat romantike janë të mundshme, po ashtu edhe udhëtimet afatshkurtra.

VIRGJËRESHA

Marsi ju ndihmon të përcaktoni kufijtë tuaj më mirë. Romanca do të bëhet edhe më intensive kur Venusi rrotullohet në sektorin e intimitetit tuaj, duke favorizuar një lidhje më të thellë me partnerin tuaj. Çështjet financiare dhe ligjore do të përmirësohen, ndaj mos u frikësoni në do t'ju duhen të tepërta shpenzimet për një pushim pranveror, pasi do t'ju ngrejë moralin!

PESHORJA

Energjia juaj do të rritet, duke ju dhënë fuqinë për të lëvizur drejt qëllimeve tuaja më të larta. Bashkimi Saturn-Pluton siguron ngritjen tuaj dhe të qëndrueshme të suksesit. Perspektivat tuaja për dashuri vazhdojnë të lulëzojnë dhe me shumë mundësi prania e Afërditës do të intensifikojë lidhjet e reja, të cilat shumë shpejt do të bëhen serioze dhe të rëndësishme për ju.

AKREPI

Ky muaj fillon në modalitetin e romancës, sepse Venusi ju premtonte momente emocionuese, pasi një periudhë të errët në jetën tuaj. Është më mirë të praktikoni përbajtjen dhe të mos i kaloni situatat në drama pa vlerë. Puna në grup do t'ju çojë drejt suksesit, por mos harroni harmonia në raport me kolegët duhet të jetë thelbësore për të ardhmen.

SHIGJETARI

Shtëpia është vendi ku është zemra juaj këtë muaj. Mërkuri në retrogradë ju nxit të bëni investime që lidhen me dekorin, ose kopshtarinë, ndaj fokusohuni aty pasi ka gjasa që kjo periudhë t'ju ndihmojë të zbuloni më shumë rreth vetes. Kjo mund të shënojë momentin kur do të kapërceni pengesat dhe të ngriheni në një nivel tjetër. Dashuria ju thërret plot pasion dhe fjalë të ëmbla.

BRICJAPI

Keni shumë ide dhe ambicie intelektuale këtë muaj në zonën tuaj kreative, ndaj me ndikimin e Marsit shtoni fuqinë dhe përqendrohuni të realizoni gjithçka keni dëshiruar. Përqendrohuni në sektorin imobilar, pasi investimet tuaja do të kthehen shumëfish. Papritmas, një vendim në sferën e ndjenjave do t'ju turbullojë, por mos u frikësoni, do të kthehet në hapin e madh të jetës!

UJORI

Mërkuri retrogradë në zonën tuaj financiare paralajmëron shpenzime të papritura, ndaj do t'ju duhet të monitoroni me kujdes portofolin tuaj deri në datën 20. Romanca të reja do të shfaqen dhe pritet të ndezin pasionin për beqarët, ndaj përpuni të ngulni këmbët fort nëse po kërkoni një lidhje afatgjatë. Nëse keni një raport, forcojeni atë me praninë tuaj në folenë tuaj.



DHURATA PERFEKTE

këtë mars

ILDA LUMANI



SHIJET TONA

NGA NËNAT TE FËMIJËT
99 RECETA SHQIPTARE



NE DY GJUHË, SHIP DHE ANGLISHT

POROSITE TANI NË 0693030810

DHE MERRE 20% ME PAK!



Estel  Jewelry



@esteljewelry
@esteljewelry_kosova

Toptani Shopping Center, Kati 0
+355 69 20 60 504
Prishtina Mall, Kosova
+383 488 876 88